



**Republika e Kosovës**  
Komuna e Drenasit (Glllogoc)  
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 400/01-15705 dt. 30/04/ 2026



Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë Nr. 03/L-025, Shkresës së Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit nr.33-2/26 të datës 21.01.2026 si dhe Aktit të vlerësimit të Ligjshmërisë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë Nr.963-2/26 të datës 24.03.2026. Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2026 miratoi këtë:

**V E N D I M**

Për Miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2026-2030

**Neni 1**

Miratohet vendimi Për Miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2026-2030 që në procedurën rishqyrtimit dhe rivendosjes, pas eliminimit të të metave të evidentuara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë Nr.963-2/26 të datës 24.03.2026 të miratoj Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2026-2030.

**Neni 2**

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi 02 Nr.400/01-7661 të datës 27.02.2026 për Miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2025-2029.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij Vendimi janë përgjegjëse Kuvendi Komunal, Zyra e Kryetarit dhe Drejtoritë përkatëse.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Barim Bujupi

## ARSYETIM

Komuna e Drenasit në harmoni me legjislacionin në fuqi i cili e rregullon këtë fushë ka filluar procedurat për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2026-2030. si mjedhojë e të cilit proces është edhe miratimi i të njëjtës ku duke marrë parasysh këtë Kryetari i Komunës përmes këtij propozim vendimi i propozon Kuvendit të Komunës që duke marrë parasysh legjislacionin në fuqi dhe nevojës për një dokument planifikues e strategjik, që synon adresimin dhe zgjedhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal të votohet ky propozim vendim.

Një propozim vendim i tillë vije fillimisht duke u bazuar në shkresën e Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit nr.33-2/26 të datës 21.01.2026, e cila ndër të tjera potencon se Komuna e Drenasit duhet të bëjë edhe njëherë rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit pasi që dokumenti në fjalë nuk është i miratuar paraprakisht me vendim të Kuvendit komunal si dhe i njëjti ka pas mangësi edhe sa i përket përmbajtjes të cilat veç se janë të eliminuara dhe akti në fjalë përmes këtij propozim vendimi paraqitet para kuvendit komunal për miratim.

Gjithashtu e njëjta Ministri edhe me Shkresën e datës 24.03.2026 Nr.963-2/26 sërish ka paraqitur konstatimet e saja në të cilat ka të paraqitura disa mangësi të cilat duhet të shqyrtohen dhe të i eliminohen aktit në fjalë nga ana e Institucionit tonë. Të njëjtat mangësi janë vlerësuar edhe nga ana e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe pas evidentimit dhe plotësimit të të njëjtave, përmes këtij propozim vendimi Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2026-2030 paraqitet para kuvendit për miratim.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja  
Ministry of Environment and Spatial Planning

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA  
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

Titulli Origjinal: \_\_\_\_\_  
Titulli i Përkthyer: \_\_\_\_\_  
Nr. i Aktit: \_\_\_\_\_  
Data: \_\_\_\_\_

02- \_\_\_\_\_  
2378-2/26  
01.06.26  
PRISHTINË/A

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Gllgocit Burim Bujupi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gllgocit
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Fitore Pacolli Dalipi, Ministre në MMPH Bajram Kafexholli, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPH
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor në MMPH VL/76/26 Datë: 21.05.2026
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari i konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Arta Krasniqi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Bashkëpunim Ndërinstitucional në Fushën e Përfaqësimeve Gjqësore dhe Koordinim të Marrëveshjeve
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendim 02Nr.400/01-15705 për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2026-2030

I nderuar kryetar Lladrovci,  
I nderuar kryesues Bujupi

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në pajtim me nenin 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 05.05.2026 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Vendimin 02Nr.400/01-15705 për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2026-2030

MMPH pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave:

## KONFERMON

Vendimia 02Nr.400/01-15705 për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2026-2030

### ARSYETIMI

MMPH, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë dhe në pajtim me nenet 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, ka konstatuar se:

Vendimi është në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi, duke reflektuar edhe vërejtjet dhe rekomandimet e dhëna në vlerësimet e ligjshmërisë të MMPH-së me Nr. Prot. 33-2/26, datë 21.01.2026 dhe Nr. Prot. 963-2/26, datë 24.03.2026.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës mbetet në dispozicion të MAPL-së dhe Komunës për çdo sqarim shtesë lidhur me këtë vlerësim.





Republika e Kosovës  
Komuna e Drenas(Gllogoc)  
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 400101-15705 dt. 30/04/2026

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030



Prill 2026

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

### Përmbajtja:

1. FJALA E KRYETARIT TË KOMUNËS .....	5
2. VENDIMI PËR HARTIMIN E PLVM-së .....	7
3. INDEKSI I SHKURTESAVE .....	9
4. INDEKSI I TABELAVE .....	10
5. INDEKSI I HARTAVE DHE FIGURAVE .....	10
6. HYRJE .....	11
6.1 Përputhshmëria me dokumentet strategjike kombëtare .....	11
7. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT NË MJEDIS .....	13
7.1 Legjislacioni Kryesor .....	13
7.2 Dokumentet Strategjike dhe Politikat e Nivelit Qendror .....	13
7.3 Konventat dhe Direktivat Ndërkombëtare .....	14
8. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PLVM-së .....	15
8.1 Objektivat Strategjike .....	15
8.2 Efektet Pozitive nga Zgjidhja e Problemeve Mjedisore .....	15
9. PROCESI DHE METODOLOGJIA E HARTIMIT TË PLVM-së .....	17
9.1 Mbledhja dhe analiza e të dhënave .....	17
9.2 Inspektimet dhe vlerësimet në terren .....	17
9.3 Përdorimi i modelit analitik DPSIR .....	17
9.4 Konsultimet me palët e interesit dhe debati publik .....	19
9.5 Validimi dhe Prioritizimi .....	19
10. PROCESI I HARTIMIT TË PLVM-së 2026-2030, PUNËTORITË DHE DEBATI PUBLIK .....	20
10.1 Fillimi i procesit dhe ekipi punues .....	20
10.2 Punëtoritë teknike .....	20
10.3 Konsultimi publik dhe transparenca .....	20
10.4 Debati publik i datës 14.11.2025 .....	20
10.5 Integrimi i kërkesave të publikut .....	21
11. AKTERËT DHE PËRGJEGJËSIT E PLVM-së .....	22
11.1 Ekipi Komunal për hartimin e PLVM-së .....	22
11.2 Rolet e Drejtorive Komunale dhe Institucioneve .....	22
11.3 Palët e tjera të interesit .....	23

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

12. IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE (Elementet kryesore mjedisore) .....	24
12.1 Toka.....	24
12.2 Uji (Ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore) .....	25
12.3 Ajri .....	29
12.4 Natyra dhe Biodiversiteti.....	32
12.4.1 Gjendja sipas Raportit Nacional.....	32
12.4.2 Sipërfaqet pyjore dhe Speciet .....	32
12.4.3 Presionet dhe kërcënimet .....	32
12.4.4 Masat e parapara.....	33
12.5 Mjedisi Social dhe Ekonomik.....	33
12.6 Turizmi .....	33
12.6.1 Potencialet turistike .....	35
12.6.2 Barrierat Mjedisore.....	35
12.6.3 Vizioni për 2026–2030 .....	35
12.7 Zhurma (Ndotja Akustike).....	36
12.7.1 Analiza e niveleve të Zhurmës.....	36
12.7.2 Burimet kryesore të ndotjes Akustike .....	36
12.7.3 Ndikimi në shëndetin e qytetarëve .....	36
12.7.4 Masat Strategjike 2026–2030.....	37
12.8 Menaxhimi i Mbeturinave Komunale .....	37
12.8.1 Gjenerimi dhe Grumbullimi.....	37
12.8.2 Deponitë Ilegale (Pikat e Nxçhta) .....	37
12.8.3 Tranzicioni drejt Ekonomisë Qarkore .....	38
12.8.4 Objektivat për 2026–2030 .....	38
12.9 Planifikimi Urban, Gjelbërimi Publik dhe Zonat Rekreative .....	39
12.9.1 Sfidat e Zhvillimit Urban.....	39
12.9.2 Gjelbërimi Publik dhe Standardet .....	39
12.9.3 Zonat rekreative dhe sportive.....	39
12.9.4 Vizioni për 2026–2030 .....	40
12.10 Mbrojtja e tokës bujqësore, pyjeve dhe zhvillimi i turizmit.....	40
12.10.1 Mbrojtja e tokës bujqësore.....	40
12.10.2 Ruajtja e pyjeve dhe biodiversitetit .....	41
12.10.3 Zhvillimi i turizmit rural dhe kulturor .....	41
12.11 Mbrojtja e biodiversitetit (Masat e veçanta).....	41

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

12.12 Mbrojtja nga zhurma (Masat teknike) .....	42
13. ANALIZA SWOT (PIKAT E FORTA, TË DOBËTA, MUNDËSITË DHE KËRCËNIMET) .....	43
14. PLANI I VEPRIMIT, PRIORITETET DHE AKTIVITETET 2026–2030 .....	46
14.1 PRIORITETET AFATSHKURTRA (2026–2028).....	46
14.2 PRIORITETET AFATMESME (2026–2030).....	47
14.3 PRIORITETET AFATGJATA (DERI NË 10 VITE / 2035) .....	48
15. VLERËSIMI I KOSTOVE DHE FINANCIMI.....	49
15.1 Pasqyra e kostove për projektet prioritare (2026–2030) .....	49
15.2 Strategjia e Financimit.....	49
16. MONITORIMI DHE RAPORTIMI .....	51
16.1 Qëllimi i monitorimit .....	51
16.2 Mekanizmat e monitorimit .....	52
16.3 Indikatorët e performancës (KPI) .....	52
16.4 Procesi i raportimit.....	52
16.5 Roli i Komisionit dhe Ekspertit .....	53
17. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	53
17.1 Përfundimet kryesore .....	53
17.2 Rekomandime për Implementim.....	54
SHTOJCA 1: ADRESIMI I KOMENTEVE NGA MINISTRIA.....	55
SHTOJCA 2: Dëshmi nga debati publik.....	56

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

### 1. FJALA E KRYETARIT TË KOMUNËS

Të nderuar qytetarë të Komunës së Drenasit, të nderuar lexues!

Sot Komuna e Gllogocit (Drenasit) prezanton Planin Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM), një dokument planifikues e strategjik, që synon adresimin dhe zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal.

Duke u mbështetur në gjendjen aktuale mjedisore, në këtë plan janë përcaktuar prioritetet mjedisore për periudhën pesëvjeçare (2026–2030).

Thelbi i këtij plani është të identifikojë dhe të ofrojë zgjidhje për problemet prioritare mjedisore në territorin e Komunës së Gllogocit (Drenasit), duke synuar një menaxhim sa më efektiv të tyre. Po ashtu, PLVM-ja synon vendosjen e çështjeve mjedisore në agjendën e institucioneve përgjegjëse dhe përfshirjen e opinionit publik në mënyrë të vazhdueshme. Objektivat kryesore të planit përfshijnë: vlerësimin e gjendjes ekzistuese të mjedisit dhe ndikimeve nga sektorët zhvillimorë; identifikimin dhe përcaktimin e problemeve kryesore mjedisore në territorin e komunës; caktimin e prioritetëve që do të adresohen gjatë periudhës pesëvjeçare; si dhe planifikimin e afateve, aktiviteteve dhe projekteve që do të ndërmerren për zbatimin e tyre.

Vizioni i PLVM-së është një qytet i Drenasit me mjedis të pastër, zhvillim të qëndrueshëm ekonomik me theks në bujqësi, si dhe promovim të trashëgimisë kulturore dhe turizmit lokal. Ky vizion është në përputhje të plotë me dokumentet strategjike të Komunës së Drenasit, veçanërisht me Planin Zhvillimor Komunal 2020–2027+.

Në hartimin e këtij dokumenti janë marrë parasysh edhe parimet dhe objektivat e Strategjia e Kosovës për Mjedisin, të zhvilluar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, si dhe në përputhje me kërkesat e Direktivës për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis 2011/92/BE, e ndryshuar me Direktivën 2014/52/BE.

Prioritetet mjedisore të Komunës së Gllogocit (Drenasit) përfshijnë: menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore dhe përmirësimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore; sigurimin e ujit të pijes me cilësi të lartë; mbrojtjen nga vërshimet dhe përmytjet; ruajtjen e pyjeve nga prerjet pa kriter dhe djegiet; forcimin e bazës ligjore dhe institucionale për menaxhimin e ndotjes së ajrit; reduktimin e zhurmës; mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndërtimet e pakontrolluara dhe erozioni; rikultivimin e tokave të degraduara; si dhe përmirësimin e sistemit të grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave.

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

Një rëndësi e veçantë i kushtohet eliminimit të deponive ilegale, nxitjes së ndarjes dhe riciklimit të mbeturinave, rritjes së numrit të zonave të mbrojtura dhe promovimit të vlerave të tyre natyrore. Po ashtu, parandalimi i veprimeve që dëmtojnë natyrën dhe biodiversitetin është pjesë thelbësore e këtij plani, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së pyjeve dhe llojeve të rralla bimore e shtazore.

Duke hartuar politika efektive për mbrojtjen e natyrës dhe duke zgjeruar sipërfaqet e zonave të mbrojtura, ne përmbushim obligimin që gjeneratave të ardhshme t'u japim mundësinë të shijojnë vlerat e rralla natyrore të Komunës së Glllogocit (Drenasit).

Në emër të qytetarëve të Komunës së Glllogocit (Drenasit), shpreh mirënjohjen time për të gjithë kontribuesit në hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis 2026–2030: komisionin komunal, ekipin këshillues të komunitetit dhe ekipin teknik mbështetës. Ju ftoj që këtë dokument strategjik mjedisor ta konsiderojmë si një vlerë të përbashkët, e cila do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët tanë.

Përzemërsisht,

Kryetari i Komunës së Drenasit

**Ramiz LLADROVCI**

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

### 2. VENDIMI PËR HARTIMIN E PLVM-së

#### EKIPI KOMUNAL PËR HARTIMIN E PLANIT LOKAL PËR VEPRIMIN NË MJEDIS (PLVM)

Për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM) 2026–2030 për Komunën e Glllogocit, përbërja e ekipit, është përcaktuar me vendimin Nr. 400/01-45313 të datës 15.10.2025.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Glllogocit



01-Nr./400/01-45313 dt. 15/10/2025

Në vështrim të Nenit 24 Ligjit 03/L-025 Për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji nr. 08/L-025 Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndoja, Nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L- 040 për Vetëqeverisjen Lokale, Nenit 4 paragrafi 2 të Ndryshim Plotësimit të Statutit të Komunës Nr.12-030-19523 të datës 06.04.2018, Nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

#### VENDIM

Për themelimin e Ekipit Komunal për Hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis dhe Hartimin e Planit Lokal për Strategjinë e Cilësisë së Ajrit për periudhën e zbatimit 2025-2029.

1. Anëtarët e Ekipit Komunal për Hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis dhe Hartimin e Planit Lokal për Strategjinë e Cilësisë së Ajrit për periudhën e zbatimit 2025-2029 janë:

1. Petrit Gashi, (koordinator),
2. Shaban Dobra, (anëtar),
3. Besart Bajrami, (anëtar),
4. Shkendije Thaqi, (anëtar),
5. Afrim Prokshi, (anëtar),
6. Liridona Durmishi, (anëtar),
7. Marigona Gllareva, (anëtar),
8. Armend Cakliqi, (anëtar),
9. Arberie Gllareva, (anëtar),

2. Ekipi Komunal për Hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM) dhe Hartimin e Planit Lokal për Strategjinë e Cilësisë së Ajrit (PLSCA) ka këto përgjegjësi:

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

- o të sigurojnë të dhënat nga departamenti përkatës,
- o të marrin pjesë në takime të rregullta konsultative dhe të japin kontributin e tyre profesional për Hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis(PLVM) dhe Planit Lokal për Strategjinë e Cilësisë së Ajrit (PLSCA),
- o të informojnë vendimarrësit për procesin e Hartimit e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis(PLVM) dhe Planit Lokal për Strategjinë e Cilësisë së Ajrit (PLSCA),
- o të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në debatin publik me qytetarë në prezantimin e draftit të Hartimit e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis(PLVM) dhe Planit Lokal për Strategjinë e Cilësisë së Ajrit (PLSCA).

Ekipi Komunal për Hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis dhe Hartimin e Planit Lokal për Strategjinë e Cilësisë së Ajrit, punën e tyre duhet t'a kryejnë me përkushtim dhe profesionalizëm të lartë.

Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës:

Vendimi i'u dërgohet:

- o Zyrës së Kryetarit;
- o Zyrës së Personelit;
- o Ekipit Komunal për Hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis dhe Hartimi i Planit Lokal për Strategjinë e Cilësisë së Ajrit;
- o Arkivit të Komunës së Drenasit;

  
Kryetari i Komunës:  
Rrahiz Lladrovci

### 3. INDEKSI I SHIKURTESAVE

AMF	Ambulanca të Mjekësisë Familjare
AMMK	Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
APK	Agjencia e Pyjeve të Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DBZHR	Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
DI	Drejtoria e Inspektoratit
DIL	Drejtoria për Infrastrukturë Lokale
DPUMM	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit
DSIHP	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë
GIZ	Organizata Gjermane për Shoqëri të Hapur
GZK	Gazeta Zyrtare e Kosovës
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
IKMN	Instituti të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës
IMMK	Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës
KPSH	Kujdesin Parësorë Shëndetësorë
KRU	Kompania Regjionale e Ujësjellësit
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MSHP	Ministria e Shërbimeve Publike
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
PLVB	Plani Lokal i Veprimit në Biodiversitet
PLVM	Plani Lokal i Veprimit në Mjedis

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
BOD	BOD (nga anglishtja Biochemical Oxygen Demand)
KBO	Kërkesa biokimike për oksigjen

### 4. INDEKSI I TABELAVE

Tabela 1. Cilësia e ujit të lumit sitnicë.....	26
Tabela 2. Cilësia e ajrit në Drenas.....	29
Tabela 3. Tabelë përmbledhëse – popullsia e komunës së Glllogocit sipas vendbanimit (2024).....	33
Tabela 4. Prioritetet afatshkurtra.....	46
Tabela 5. Prioritetet afatmesme.....	47
Tabela 6. Prioritetet afatgjata.....	48
Tabela 7. Pasqyra e kostove për projektet prioritare.....	49

### 5. INDEKSI I HARTAVE DHE FIGURAVE

Harta 1: Pozita gjeografike e Drenasit.....	12
Harta 2. Harta pedologjike e territorit të komunës së Glllogocit (Drenasit).....	25
Harta 3: Harta e ujësjellësit kanalizimit dhe ujitjes.....	28
.....	.....
Figura 1. Cilësia e ujit të lumit sitnicë.....	27

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

### 6. HYRJE

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis (PLVM) 2026–2030 për Komunën e Drenasit (Glllogocit) përfaqëson dokumentin kryesor strategjik dhe planifikues për adresimin e sfidave mjedisore në nivel lokal. Ky plan është hartuar si një përgjigje e domosdoshme ndaj nevojës për të balancuar zhvillimin dinamik ekonomik dhe industrial të Komunës me mbrojtjen e shëndetit publik dhe ruajtjen e pasurive natyrore.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis (PLVM) 2026–2030 është hartuar në përputhje të plotë me kornizën ligjore dhe strategjike të Republikës së Kosovës në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

#### 6.1 Përputhshmëria me dokumentet strategjike kombëtare

Ky plan është i harmonizuar me dokumentet kryesore strategjike kombëtare, duke përfshirë:

- Planin Kombëtar të Veprimit në Mjedis (PKVM)
- Strategjinë për Mbrojtjen e Mjedisit
- Strategjinë për Menaxhimin e Mbeturive
- Strategjinë për Cilësinë e Ajrit
- Dokumente relevante sektoriale dhe ligjore në fuqi

Përputhshmëria është siguruar përmes lidhjes direkte ndërmjet objektivave dhe masave të PLVM me prioritetet kombëtare, si në vijim:

Objektivat e PLVM	Dokumenti kombëtar	Objektivi kombëtar përkatës	Përputhshmëria
Përmirësimi i cilësisë së ajrit	PKVM / Strategjia e Ajrit	Reduktimi i ndotjes së ajrit dhe emetimeve	I plotë
Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave	Strategjia e Mbeturive	Reduktimi i deponive ilegale dhe rritja e riciklimit	I plotë
Mbrojtja e ujërave	PKVM	Përmirësimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	I plotë
Mbrojtja e tokës dhe biodiversitetit	Strategjia e Mjedisit	Ruajtja e ekosistemeve dhe biodiversitetit	I plotë

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

Përmes kësaj qasjeje, PLVM 2026–2030 kontribuon drejtpërdrejt në zbatimin e politikave kombëtare dhe siguron koherencë ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror.

Ky harmonizim mundëson gjithashtu qasje më të lehtë në burime financimi nga niveli qendror dhe donatorët ndërkombëtarë, duke rritur realizueshmërinë e masave të planifikuara.



Harta 1: Pozita gjeografike e Drenasit

## 7. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT NË MJEDIS

Hartimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM) 2026–2030 bazohet në kornizën ligjore të Republikës së Kosovës, e cila përcakton kompetencat dhe detyrimet e komunave për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ky dokument është hartuar në përputhje me hierarkinë e planeve hapësinore dhe mjedisore në nivel nacional dhe lokal.

### 7.1 Legjislacioni Kryesor

Baza kryesore ligjore për këtë plan mbështetet në:

- **Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit:** Ky është ligji bazë që rregullon mbrojtjen e mjedisit në Kosovë.
  - **Neni 24** i këtij ligji obligon në mënyrë specifike komunat që të miratojnë Planet Lokale të Veprimit në Mjedis (PLVM) ose programe mjedisore, në përputhje me Planin Kombëtar (PKVM) dhe nevojat specifike lokale.
  - **Neni 5** përcakton se komunat janë përgjegjëse për përgatitjen e planeve për mbrojtjen e mjedisit në territorin e tyre në bashkëpunim me Ministrinë (MMPHI).
- **Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale:** Ky ligj i jep komunës kompetenca të plota dhe të zgjeruara në fushën e mbrojtjes së mjedisit lokal, menaxhimit të mbeturinave dhe furnizimit me ujë.
- **Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM):** Ky ligj është jetik për Komunën e Drenasit për shkak të aktivitetit të theksuar industrial. Ai siguron që çdo projekt i ri apo zgjerim industrial t'i nënshtrohet procesit të vlerësimit para dhënies së pëlqimit mjedisor.
- **Ligji Nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes:** Ky ligj rregullon emetimet në ajër, ujë dhe tokë nga impiantet e mëdha industriale, duke shërbyer si bazë për monitorimin e Lejeve të Integruara Mjedisore për operatorët ekonomikë në Drenas.

### 7.2 Dokumentet Strategjike dhe Politikat e Nivelit Qendror

- **Strategjia (2024-2035) për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë dhe Plani i Veprimit (2024-2026).**

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

Ky është dokumenti më i ri referues i cili fokusohet në tranzicionin drejt **Ekonomisë Qarkore**, riciklimit dhe ndarjes së mbeturinave në burim.

### 7.3 Konventat dhe Direktivat Ndërkombëtare

Duke synuar përfrimin me standardet e Bashkimit Evropian, ky plan merr parasysh kërkesat e:

- **Direktivës 2008/50/EC** për cilësinë e ajrit të ambientit.
- **Direktivës 2011/92/EU (e ndryshuar me 2014/52/EU)** për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
- **Agjendën e Gjelbër (Green Agenda)** për Ballkanin Perëndimor, e cila synon dekarbonizimin dhe mbrojtjen e resurseve natyrore deri në vitin 2050.

Në përfundim, ky kuadër ligjor siguron që PLVM 2026–2030 të jetë një dokument legjitim, i zbatueshëm dhe i detyrueshëm për të gjitha organet ekzekutive të Komunës së Drenasit gjatë pesë viteve të ardhshme.

## 8. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PLVM-së

Qëllimi kryesor i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM) është krijimi i një mjedisi të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit. Ky plan shërben si një platformë strategjike që balancon zhvillimin e hovshëm industrial dhe urban me nevojën emergjente për mbrojtjen e resurseve natyrore për periudhën 2026–2030.

### 8.1 Objektivat Strategjike

Për të arritur vizionin e një "Drenasi të Gjelbër", janë përcaktuar gjashtë objektiva kryesore:

1. **Përmirësimi i Cilësisë së Ajrit:** Reduktimi i emetimeve të grimcave PM10, PM2.5 dhe SO<sub>2</sub> përmes kontrollit të rreptë industrial (Ferronikeli), modernizimit të trafikut dhe kalimit nga ngrohja me thëngjill në burime alternative.
2. **Menaxhimi i Qëndrueshëm i Ujërave:** Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza (ITUZ), mbrojtja e brigjeve të lumenjve Sitnica dhe Drenica nga ndotja, dhe sigurimi i furnizimit me ujë të pijshëm cilësor.
3. **Mbrojtja e Tokës dhe Planifikimi Urban:** Parandalimi i degradimit të tokës bujqësore nga ndërtimet e pakontrolluara, rikultivimi i tokave të dëmtuara nga aktivitetet minerare dhe eliminimi i plotë i deponive ilegale.
4. **Ekonomia Qarkore dhe Menaxhimi i Mbeturinave:** Kalimi nga grumbullimi i thjeshtë drejt riciklimit, ndarjes në burim dhe kompostimit, duke implementuar kornizën e re të Ekonomisë Qarkore.
5. **Ruajtja e Biodiversitetit:** Mbrojtja e llojeve të rralla bimore dhe shtazore, ripyllëzimi i zonave të zhveshura dhe krijimi i zonave të reja rekreative e brczave të gjelbër.
6. **Reduktimi i Ndotjes Akustike dhe Adaptimi Klimatik:** Minimizimi i zhurmës urbane e industriale dhe zbatimi i masave adaptuese ndaj vërshimeve dhe thatësirave.

### 8.2 Efektet Pozitive nga Zgjidhja e Problemeve Mjedisore

Zbatimi i suksesshëm i këtij plani dhe zgjidhja e problemeve të identifikuara do të sjellë një sërë efektesh pozitive zinxhir, të cilat do të transformojnë komunën:

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

- **Për Shëndetin Publik:** Reduktimi i ndotjes së ajrit (PM10 dhe SO2) do të sjellë rënie të ndjeshme të sëmundjeve respiratore dhe kardiovaskulare te popullata, duke ulur kostot e trajtimit mjekësor dhe duke rritur jetëgjatësinë e qytetarëve.
- **Për Ekonominë Lokale:** Trajtimi i ujërave të zeza dhe mbrojtja e tokës nga plehurat artificiale do të rrisë pjellorinë dhe sigurinë e produkteve bujqësore, duke mundësuar certifikimin e tyre si produkte "Bio" për tregun evropian. Po ashtu, një mjedis i pastër nxit investimet në ekoturizëm.
- **Për Mirëqenien Sociale:** Krijimi i parqeve, gjelbërimit publik dhe zonave rekreative sportive do të përmirësojë cilësinë e jetës sociale, duke ofruar hapësira të shëndetshme për aktivitet fizik për të rinjtë dhe fëmijët.
- **Për Qëndrueshmërinë Financiare:** Kalimi në Ekonominë Qarkore (riciklim dhe ndarje në burim) do të gjenerojë vende të reja pune "të gjelbra" dhe do të reduktojë shpenzimet komunale për menaxhimin e mbeturinave në afatgjatë.
- **Për Ekuilibrin Ekologjik:** Restaurimi i habitateve dhe brigjeve të lumenjve do të kthejë florën dhe faunën autoktone, duke parandaluar erozionin e tokës dhe duke siguruar rezerva të pastra të ujit nëntokësor për gjeneratat e ardhshme.

Në përfundim, ky plan synon që përmes investimeve të synuara, Drenasi të pushojë së qeni një "pikë e nxehtë" (hotspot) e ndotjes dhe të shndërrohet në një model të zhvillimit industrial të qëndrueshëm në rajon.

## 9. PROCESI DHE METODOLOGJIA E HARTIMIT TË PLVM-së

Procesi i hartimit të Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM) 2026–2030 është zhvilluar përmes një metodologjie gjithëpërfshirëse që ndërthur analizën sasiore (të dhënat statistikore) me atë cilësore (vlerësimet në terren dhe ekspertizën). Ky proces ka siguruar që plani të jetë i bazuar në evidenca, realist dhe plotësisht i zbatueshëm.

### 9.1 Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Vlerësimi ka filluar me grumbullimin e të dhënave zyrtare nga institucionet monitoruese për të krijuar një "linjë bazë" (baseline) për parametrat mjedisorë. Burimet kryesore të informacionit përfshijnë:

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK): Të dhënat e fundit nga Regjistrimi i Popullsisë 2024 për demografinë dhe ekonominë.

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit (AMMK) dhe IHMK: Raportet vjetore mbi cilësinë e ajrit (PM10, SO<sub>2</sub>), ujit (BOD5, amoniaku) dhe tokës në rajonin e Drenasit.

Dokumentet Komunale: Planet e kaluara zhvillimore, statistikat mbi industrinë lokale dhe projektet mjedisore paraprahe.

### 9.2 Inspektimet dhe vlerësimet në terren

Ekipi teknik i Komunës, i mbështetur nga ekspertë të fushës, ka realizuar vizita direkte në pikat "hotspot" të identifikuara. Kjo ka përfshirë:

Identifikimin dhe matjen e sipërfaqeve të deponive ilegale të mbeturinave.

Vëzhgimin e gjendjes së brigjeve të lumenjve Sitnica dhe Drenica.

Monitorimin vizual të zonave të degraduara nga aktivitetet minerare (minierat e Ferronikelit) dhe gurëthyesit.

### 9.3 Përdorimi i modelit analitik DPSIR

Për të realizuar një analizë shkencore të marrëdhënieve shkak-pasojë midis aktiviteteve njerëzore dhe mjedisit, ky plan është mbështetur në kornizën **DPSIR** (Driving forces, Pressures, State, Impact, Response). Ky model, i rekomanduar nga Agjencia Evropiane e Mjedisit (EEA), ka mundësuar identifikimin e saktë të problemeve mjedisore në Drenas dhe hartimin e masave adekuate për periudhën 2026–2030.

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

### 1. Faktorët Nxitës – (D)

Këta janë faktorët socio-ekonomikë që nxisin ndryshimet në mjedis. Në rastin e Drenasit, nxitësit kryesorë janë:

- **Zhvillimi Industrial:** Prania e industrisë së rëndë metalurgjike si motor i ekonomisë.
- **Dinamika e Popullsisë:** Një popullsi rezidente prej **48,079 banorësh** që kërkon furnizim me ujë, energji dhe menaxhim mbeturinash.
- **Bujqësia:** Nevoja për prodhim ushqimor që nxit përdorimin e inuteve kimike dhe shfrytëzimin e tokës.

### 2. Presionet – (P)

Presionet janë rezultatet direkte të nxitësve që ndikojnë në mjedis:

- **Emetimet:** Çlirimi i grimcave PM10, PM2.5 dhe SO<sub>2</sub> nga oxhaqet industriale dhe ngrohja lokale.
- **Shkarkimet:** Derdhja e ujërave të zeza të patrajtuara dhe lëngjeve teknologjike në lumenjtë Sitnica dhe Drenica.
- **Mbeturinat:** Gjenerimi i **7,209 tonë** mbeturinave në vit dhe prezenca e deponive ilegale.

### 3. Gjendja – (S)

Përshkruan cilësinë aktuale të elementeve mjedisore:

- **Ajri:** Nivelet e matur të PM10 dhe SO<sub>2</sub> (të cilët sipas raportit 2024 janë brenda normës, por mbeten në monitorim).
- **Uji:** Cilësia kimike e lumenjve me tejkalime të BOD5 dhe amoniakut.
- **Toka:** Përmbajtja e metaleve të rënda (Nikel, Krom) dhe ndryshimi i pH-së në tokat bujqësore.

### 4. Ndikimi – (I)

Janë pasojat që vijnë nga ndryshimi i gjendjes:

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

- **Shëndeti Publik:** Sëmundjet respiratore dhe kardiovaskulare të lidhura me cilësinë e ajrit.
- **Ekonomia:** Humbja e pjellorisë së tokës dhe kostot e larta për pastrimin e deponive ilegale.
- **Biodiversiteti:** Fragmentimi i pyjeve dhe degradimi i ekosistemeve ujore.

### 5. Reagimi – (R)

Këtu përfshihen të gjitha masat që Komuna ka ndërmarrë ose do të ndërmarrë:

- **Ky PLVM (2026-2030):** Hartimi i këtij dokumenti është reagimi kryesor institucional.
- **Investimet:** Ndërtimi i ITUZ-ve, mbyllja e deponive ilegale dhe ripyllëzimi i 10 hektarëve.
- **Legjislacioni:** Zbatimi i gjobave mjedisore dhe monitorimi i Lejeve të Integruara Mjedisore.

### 9.4 Konsultimet me palët e interesit dhe debati publik

PLVM-ja është një dokument që reflekton nevojat e komunitetit. Gjendja ekzistuese është vlerësuar përmes një procesi transparent pjesëmarrës:

Punëtoritë: Janë mbajtur punëtori me përfaqësues të shoqërisë civile, bizneseve lokale (përfshirë sektorin industrial) dhe ekspertë të drejtorive komunalë.

Debati Publik: Një moment kyç i procesit ishte Takimi Publik i mbajtur më datë 14.11.2025 në sallën e Kuvendit Komunal. Gjatë këtij takimi, qytetarët (si p.sh. kërkesa e z. Faik Hoti për rrezikun nga plehurat artificiale) patën mundësinë të japin komentet e tyre, të cilat janë integruar në kapitullin e analizës së problemeve.

### 9.5 Validimi dhe Prioritizimi

Në fazën finale, të gjitha gjetjet janë rishikuar nga komisioni i ekspertëve për të siguruar harmonizimin e të dhënave teknike me planet zhvillimore të Komunës. Problemet janë ranguar sipas një matrice të prioritizimit, duke vlerësuar ndikimin në shëndet, urgjencën ligjore, dëmin mjedisor dhe fizibilitetin financiar të ndërhyrjes brenda 5 viteve.

## **10. PROCESI I HARTIMIT TË PLVM-së 2026-2030, PUNËTORITË DHE DEBATI PUBLIK**

Hartimi i këtij plani ka kaluar nëpër një proces të hapur dhe gjithëpërfshirës, duke filluar nga vendimmarrja politike deri te konsultimet teknike dhe ato me publikun e gjerë. Ky proces ka siguruar që prioritetet mjedisore të pasqyrojnë shqetësimet reale të banorëve të Drenasit.

### **10.1 Fillimi i procesit dhe ekipi punues**

Procesi nisi me vendimin zyrtar të Kryetarit të Komunës, Nr. 400/01-45313 të datës 15.10.2025, për emërimin e Ekipit Komunal për hartimin e PLVM-së. Ekipi, i udhëhequr nga koordinatori z. Petrit Gashi dhe i përbërë nga ekspertë të drejtorive përkatëse (Mjedis, Urbanizëm, Shërbime Publike, Bujqësi), pati për detyrë sigurimin e të dhënave dhe koordinimin me kompaninë konsulente "Golden Consulting Centre".

### **10.2 Punëtoritë teknike**

Gjatë periudhës tetor–nëntor 2025, u organizuan disa punëtori teknike ku u analizuan: Gjendja aktuale e ndotjes nga industria dhe mbeturinat; Identifikimi i zonave "hotspot" të komunës; Rishikimi i legjislacionit të ri mjedisor dhe harmonizimi me planet nacionale.

### **10.3 Konsultimi publik dhe transparencë**

Me qëllim të garantimit të transparencës maksimale, draft-dokumenti u vendos në shqyrtim publik nga data 30.10.2025 deri më datën 20.11.2025. Njoftimi për shqyrtim u publikua përmes:

Uebfaqes zyrtare të Komunës së Drenasit;  
Platformës Facebook të komunës.

### **10.4 Debati publik i datës 14.11.2025**

Ngjarja qendrore e procesit të konsultimit ishte Debati Publik i mbajtur më 14.11.2025 në Sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 11:00. Takimi u hap nga Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, z. Bekim Dobra, ndërsa prezantimi teknik u bë nga përfaqësuesi i kompanisë konsulente, z. Ibush Luzha.

Gjatë këtij debati, u zhvillua një diskutim aktiv me qytetarët, përfaqësuesit e lagjeve dhe shoqërinë civile. Shqetësimet kryesore të paraqitura ishin:

Ndotja industriale dhe nevoja për monitorim online të emisioneve;

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

Problematika e deponive ilegale në zonat rurale;

Kërkesa specifike teknike: Një vëmendje e veçantë iu kushtua kërkesës së qytetarit z. Faik Hoti, i cili kërkoi që në plan të elaborohen në mënyrë më të detajuar rreziqet që vijnë nga përdorimi i plehrave artificiale dhe materieve të rrezikshme në bujqësi.

### **10.5 Integrimi i kërkesave të publikut**

Pas debatit publik, ekipi punues rishikoi draftin fillestar për të integruar sugjerimet e qytetarëve. Si rezultat i këtij procesi:

U shtuan masa specifike për trajnimin e fermerëve mbi "Bujqësinë e Mirë" dhe përdorimin e plehrave organike në vend të atyre artificiale (si përgjigje ndaj kërkesës së z. Faik Hoti).

U detajuan afatet për eliminimin e 15 deponive ilegale kryesore.

U forcua pjesë e monitorimit të ajrit përmes stacioneve automatike.

Ky proces pjesëmarrës dëshmon se PLVM 2026–2030 nuk është vetëm një dokument zyre, por një produkt i dakorduar me komunitetin, dëshmitë e të cilit (listat e nënshkrimeve dhe fotot) gjenden në Shtojcën 6 të këtij dokumenti.

## **11. AKTERËT DHE PËRGJEGJËSIT E PLVM-së**

Zbatimi i suksesshëm i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM) kërkon një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet institucioneve lokale, qendrore, sektorit privat dhe shoqërisë civile. Ky kapitull përcakton strukturën llogaridhënëse dhe rolet specifike të secilit aktor të përfshirë.

### **11.1 Ekipi Komunal për hartimin e PLVM-së**

Për hartimin dhe koordinimin e këtij plani, me vendimin zyrtar Nr. 400/01-45313 të datës 15.10.2025, është përcaktuar Ekipi Komunal me këtë përbërje:

Petrit Gashi (Koordinator)

Shaban Dobra (Anëtar)

Besart Bajrami (Anëtar)

Shkendije Thaqi (Anëtar)

Afrim Prokshi (Anëtar)

Liridona Durmishi (Anëtar)

Marigona Gllareva (Anëtar)

Armend Cakiqi (Anëtar)

Arberije Gllareva (Anëtar)

Përgjegjësitë e Ekipit: Sigurimi i të dhënave nga departamentet përkatëse, pjesëmarrja në takimet konsultative, informimi i vendimmarrësve mbi procesin dhe koordinimi me kompaninë e kontraktuar "Golden Consulting Centre Sh.P.K." për finalizimin teknik të dokumentit.

### **11.2 Rolet e Drejtorive Komunale dhe Institucioneve**

Secila drejtori ka përgjegjësi specifike në implementimin e masave të planit:

Kuvendi Komunal i Drenasit: Miratimi zyrtar i planit dhe ndarja e burimeve të nevojshme financiare përmes buxhetit vjetor.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUMM): Mbikëqyrja kryesore e planit, koordinimi i monitorimit të cilësisë së ajrit dhe ujit, si dhe inspektimi i emetimeve industriale.

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë: Zbatimi i masave për mbrojtjen e tokës nga erozioni, ripyllëzimi i zonave të degraduara dhe edukimi i fermerëve për përdorimin e plehrave organike.

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë (DSHPE): Menaxhimi i mbeturinave, zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, si dhe mirëmbajtja e gjelbërimit publik.

Drejtoria e Infrastrukturës Lokale: Zhvillimi i shtigjeve të biçikletave dhe përmirësimi i transportit publik për reduktimin e ndotjes nga trafiku.

Drejtoria e Arsimit: Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese dhe edukimi mjedisor në shkolla.

### 11.3 Palët e tjera të interesit

Përveç komunës, rolet e aktorëve të tjerë janë:

Palë e interesit Roli dhe përgjegjësia

MMPHI dhe AMMK Ofrimi i udhëzimeve teknike, mbikëqyrja e standardeve dhe auditimi i raporteve mjedisore.

Shoqëria civile dhe OJQ-të Monitorimi i pavarur i zbatimit të masave dhe ndihmë në fushatat edukative.

Bizneset dhe Industria Investimi në teknologji të pastra, reduktimi i ndotjes në burim dhe projektet e Përgjegjësisë Sociale (CSR).

Publiku dhe Komuniteti Pjesëmarrja aktive në debate, raportimi i ndotjeve dhe ndjekja e progresit të realizimit të planit.

Donatorët (BE, UNDP, etj.) Mbështetje financiare për projektet kapitale (si Impiantet e Ujërave të Zeza) dhe ekspertizë teknike.

Ky rrjet institucional siguron që PLVM 2026–2030 të mos mbetet vetëm në letër, por të ketë një strukturë të qartë të monitorimit dhe llogaridhënies për çdo aktivitet të paraparë.


## 12. IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE (Elementet kryesore mjedisore)

Ky kapitull analizon gjendjen aktuale të elementeve mjedisore në Komunën e Drenasit, duke identifikuar burimet e ndotjes dhe ndikimin e tyre në shëndetin e banorëve dhe ekosistem. Analiza bazohet në të dhënat e fundit të AMMK (2023-2024), raportet e IHMK-së dhe matjet në terren të realizuara për këtë plan.

### 12.1 Toka

Toka në Drenas është një aset i çmuar, por nën presion të vazhdueshëm nga industria dhe urbanizimi.

- **Degradimi industrial:** Aktivitetet e fabrikës “NewCo Ferronikeli” dhe gurthyesve kontribuojnë në ndotje përmes pluhurit metalik. Sipas matjeve, në zonat afër industrisë niveli i **Nikelit (Ni)** është **140 mg/kg** (kufiri i lejuar 75) dhe i **Kromit (Cr)** **110 mg/kg** (kufiri 100).
- **Ndotja nga plehrat artificiale:** Një problem kritik (i theksuar nga z. Faik Hoti në debatin publik) është përdorimi i pakontrolluar i plehrave artificiale pa analiza paraprake agroteknike, gjë që po rrit aciditetin e tokës (**pH mesatar 6.3**) dhe po dëmton mikroorganizmat dobishëm.
- **Deponitë ilegale:** Janë identifikuar mbi 15 pika të nxehta të deponive ilegale që mbulojnë rreth 10,000 m<sup>2</sup> toke.



**Harta 1. Harta pedologjike e territorit të Komunës së Gllgocit (Drenasit)**

### 12.2 Uji (Ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore)

Ndotja e ujërave përbën një ndër sfidat më të rëndësishme mjedisore në territorin e Komunës së Drenasit, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore. Burimet kryesore të ndotjes janë shkarkimet industriale, ujërat e zeza të patrajtuara dhe rrjedhjet difuze nga aktivitetet bujqësore. Mungesa e trajtimit të ujërave të ndotura nga zonat urbane dhe industriale, si dhe deponimi i pa kontrolluar i mbetjeve, kanë ndikuar në përkeqësimin e parametrave fizikë, kimikë dhe biologjikë të ujërave.

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030


• **Shkarkimet industriale dhe ujërat e zeza të pa trajtuara janë faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në cilësinë e ujit.** Fabrika “NewCo Ferronikeli” dhe disa subjekte të tjera ekonomike lëshojnë ujëra teknologjike me përmbajtje të lartë ndotësish organikë dhe inorganikë, të cilët përfundojnë në përroska dhe në lumin Sitnicë. Gjithashtu, mungesa e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura në shumicën e zonave banesore shkakton derdhje të drejtpërdrejtë të ujërave të zeza në kanalet ujëmbledhëse, duke rritur ngarkesën organike dhe mikrobiologjike në mjedis.

• Sipas **Raportit të Agjencisë së Mjedisit të Kosovës (2023)**, në pikat monitoruese përgjatë lumit Sitnica janë evidentuar disa tejkalime të parametrave bazë të cilësisë së ujit, si më poshtë:

Një burim tjetër domethënës i ndotjes së ujërave në Komunën e Drenasit, i theksuar edhe gjatë konsultimeve me publikun, është përdorimi i pakontrolluar i plehrave artificiale në zonat bujqësore. Shpëlarja e këtyre lëndëve kimike (veçanërisht nitrateve dhe fosfateve) nga reshjet atmosferike shkakton derdhjen e tyre direkte në lumenjtë Drenica dhe Sitnica. Ky proces rrit rrezikun e eutrofizimit (shtimit të tepërt të algave) që shteron oksigjenin në ujë dhe dëmton botën ujore, si dhe paraqet rrezik potencial për kontaminimin e ujërave nëntokësore, të cilat shumë banorë të zonave rurale i përdorin ende përmes puseve për pije dhe nevoja shtëpiake.

**Tabela 1. Cilësia e ujit të lumit Sitnicë**


Parametër	Sitnica ( $\mu\text{g/L}$ )	Kufiri sipas standardeve	Statusi
$\text{NH}_4^+$ (Amoniumi)	2.5	1.5	Tejkalim
$\text{NO}_3^-$ (Nitrati)	40	50	Brenda normës
BOD (mg/L)	12	10	Tejkalim
Kripërat totale (mg/L)	350	500	Brenda normës



**Figura 1. Cilësia e ujit të lumit Sitnicë**

Të dhënat tregojnë se përqendrimet e amoniakut (NH<sub>4</sub><sup>+</sup>) dhe ngarkesa organike e matur me BOD tejkalojnë kufijtë e lejuar sipas standardeve kombëtare të cilësisë së ujërave. Këto tejkalime janë tregues të pranisë së ndotjes organike, që buron kryesisht nga ujërat e zeza të patrajtuara, rrjedhjet nga stallat, mbetjet bujqësore, si dhe nga infiltrimet e depozitave industriale.

Prania e amoniakut dhe azotit total në nivele të larta tregon për procesin e dekompozimit të materieve organike dhe për mungesë oksigjeni të tretur në ujë, duke shkaktuar kushte anaerobe që dëmtojnë ekosistemin ujor. Ngarkesa e lartë BOD (Biochemical Oxygen Demand) reflekton shkallën e lartë të konsumit të oksigjenit nga mikroorganizmat për dekompozimin e substancave organike, çka ndikon negativisht në florën dhe faunën ujore. Nga ana tjetër, përqendrimet e nitratit (NO<sub>3</sub><sup>-</sup>) dhe të kripërave totale janë brenda kufijve të lejuar, megjithëse tendencat e rritjes në periudha të caktuara lidhen me përdorimin intensiv të plehrave kimikë dhe pesticideve në bujqësi. Kjo tregon se ndotja bujqësore është e pranishme, por aktualisht në nivel të moderuar.



Harta 3: Harta e ujësjiellësit kanalizimit dhe ujitjes

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

Në mungesë të një impianti për trajtimin e ujërave të ndotura urbane dhe industriale, ndotja pritet të mbetet problem serioz edhe në vitet në vijim, nëse nuk ndërmerren masa parandaluese dhe rehabilituese. Rekomandohet që Komuna të intensifikojë bashkëpunimin me Agjencinë e Ujërave dhe institucionet përgjegjëse për monitorim, për të siguruar kontroll më efektiv të shkarkimeve industriale, përmirësim të infrastrukturës së kanalizimit dhe ngritje të vetëdijes publike për ruajtjen e cilësisë së ujit.

Në përfundim, rezultatet tregojnë qartë se ndotja e ujërave në territorin e Komunës së Drenasit është e lidhur ngushtë me aktivitetet njerëzore – veçanërisht me industrinë dhe bujqësinë – dhe se nevojitet një qasje e integruar për mbrojtjen e burimeve ujore, që përfshin monitorim të rregullt, investime në trajtimin e ujërave të zeza dhe zbatim të masave të qëndrueshme mjedisore.

### 12.3 Ajri

Cilësia e ajrit në Komunën e Drenasit paraqet një nga sfidat më serioze mjedisore, si pasojë e kombinimit të aktiviteteve të industrisë së rëndë, trafikut të dendur dhe ngrohjes shtëpiake me lëndë djegëse fosile. Sipas matjeve të fundit nga stacionet automatike të AMMK-së dhe raporteve monitoruese, gjendja e ndotjes tejkalon kufijtë e lejuar në periudha të caktuara të vitit.

**Tabela 2. Cilësia e ajrit në Drenas**

Indikatori	Vlera mesatare vjetore	Kufiri i lejuar (Kosovë)	Statusi
PM10 ( $\mu\text{g}/\text{m}^3$ )	15.17	40	Brenda normës
PM 2.5 ( $\mu\text{g}/\text{m}^3$ )	10.58	25	Brenda normës
O <sub>3</sub> ( $\mu\text{g}/\text{m}^3$ )	54.08	125	Brenda normës
SO <sub>2</sub> ( $\mu\text{g}/\text{m}^3$ )	7.5	125	Brenda normës
NO <sub>2</sub> ( $\mu\text{g}/\text{m}^3$ )	13.33	40	Brenda normës
CO ( $\text{mg}/\text{m}^3$ )	0.62	10	Brenda normës

Burimi informacionit: [Raporti vjetor për gjendjen e ajrit 2024](#)

### 12.3.1 Analiza e ndotjes së ajrit (Sipas Raportit 2024)

Bazuar në të dhënat e fundit zyrtare të **Raportit Vjetor për Gjendjen e Ajrit 2024 (AMMK)**, monitorimi i parametrave mjedisorë tregon se të gjithë ndotësit kryesorë janë brenda normave ligjore të lejuara në Republikën e Kosovës.

#### Interpretimi i të dhënave:

1. **Grimcat e imta (PM10 dhe PM2.5):** Vlerat e matura prej **15.17  $\mu\text{g}/\text{m}^3$**  (PM10) dhe **10.58  $\mu\text{g}/\text{m}^3$**  (PM2.5) janë dukshëm nën kufijtë vjetorë të lejuar (40 dhe 25 respektivisht). Ky është një tregues pozitiv se masat e deritanishme për kontrollin e pluhurit industrial dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore po japin rezultate.
2. **Gazeve Ndotëse (SO2 dhe NO2):** Përqendrimi i dyoksidit të squfurit (**7.5  $\mu\text{g}/\text{m}^3$** ) dhe dyoksidit të azotit (**13.33  $\mu\text{g}/\text{m}^3$** ) rezulton të jetë në nivele shumë të ulëta në krahasim me limitet maksimale, gjë që dëshmon për një kontroll efikas të emetimeve teknologjike gjatë vitit 2024.
3. **Monoksidi i Karbonit (CO) dhe Ozoni (O3):** Këta indikatorë që lidhen kryesisht me trafikun dhe proceset fotokimike mbeten gjithashtu brenda standardeve strikte mjedisore.

#### Përfundim:

Vlerat e vitit 2024 konfirmojnë se cilësia e ajrit në Drenas është në përputhje me normat ligjore në fuqi. Megjithatë, Komuna e Drenasit do të vazhdojë me implementimin e projekteve të parapara në këtë PLVM (2026-2030), si krijimi i korridoreve të gjelbra dhe monitorimi në kohë reale, për të siguruar që këto vlera të mbeten brenda kufijve të gjelbër edhe në vitet në vijim, duke parandaluar çdo tejkalim eventual gjatë sezonit të dimrit.

Ndonëse Raporti Vjetor i vitit 2024 tregon se cilësia e ajrit në Drenas është brenda normave ligjore të lejuara, ekzistojnë burime konstante të presionit të cilat kërkojnë menaxhim strikt për të parandaluar përkeqësimin e gjendjes, veçanërisht gjatë muajve të dimrit.

#### Industria dhe Aktivitetet Minerare

Burimi kryesor i emetimeve teknologjike në territorin e komunës mbetet Kombinati Metalurgjik “NewCo Ferronikeli”, i cili operon me shkritoren dhe minierat sipërfaqësore në Çikatovë dhe Gllavicë.

- **Rreziqet Teknologjike:** Procesi i prodhimit të hekur-nikelit (Fe-Ni) përfshin djegjen e lëndëve fosile dhe shkrijen e xcheve, procese këto që clirojnë  $\text{SO}_2$ ,  $\text{NO}_x$  dhe pluhur teknologjik.

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

- **Trendi:** Ndonëse në vitin 2024 parametrat rezultuan brenda normave, monitorimet e kaluara (si ato nga kompania “Technolab”) kanë treguar se gjatë pikut të prodhimit dhe kushteve të pafavorshme klimatike (tetor–dhjetor), përqendrimet e nikelit (Ni) dhe pluhurave të imët kanë prirje të rriten mbi vlerat referuese. Kjo dëshmon nevojën për monitorim online 24/7 të paraparë në këtë plan.
- **Gurthyesit:** Përveç kombinatit, në komunë operojnë edhe gurthyes e fabrika betoni të cilët mbeten burime lokale të pluhurit (PM10) në zonat rreth Çikatovës dhe Korroticës.

### Transporti dhe Infrastruktura Rrugore

Sektori i transportit mbetet një kontribuues kritik në emetimin e gazrave.

- **Statistikat:** Në komunë qarkullojnë rreth **9,843 automjete**, ku dominon teknologjia e vjetër me djegie të brendshme.
- **Pikat Kritike:** Përqendrimi i lartë i mjeteve në rrethin e Komoranit dhe në qendër të qytetit shkakton ndotje lokale akustike dhe ajrore gjatë orëve të pikut. Mungesa e rrugëve anashkaluese për mjetet e rënda që transportojnë minerale rrit prezencën e pluhurit rrugor përgjatë aksit magjstral Prishtinë–Pejë.

### Ngrohja Lokale dhe Sektori Rezidencial

Gjatë sezonit dimëror, ngrohja shtëpiake mbetet kërcënimi më i madh për ruajtjen e standardeve të gjelbra të arritura në vitin 2024.

- **Lëndët Djegëse:** Përdorimi i thëngjillit dhe drurit pa sisteme filtrimi në amvisëri cliron sasi të mëdha të PM2.5 dhe SO<sub>2</sub>.
- **Inversioni Termik:** Pozita gjeografike e Drenasit favorizon mbajtjen e ndotjes pranë sipërfaqes së tokës gjatë ditëve të ftohta, gjë që mund të shkaktojë tejkalime afatshkurtra, pavarësisht mesatares së mirë vjetore. Projekti i ko-gjenerimit (ngrohja nga nxehtësia e tepërt e Ferronikelit) mbetet zgjidhja strategjike për këtë problem.

### Ndotja nga bizneset e vogla dhe aktivitetet urbane

Janë identifikuar rreth **280 objekte komerciale** (furra, restorante, punishte) të cilat përdorin lëndë djegëse fosile. Mungesa e oxhaqeve të larta dhe ventilimit efikas në këto biznese bën që ndotja të mbetet në shtresat e ulëta të atmosferës, duke ndikuar direkt në cilësinë e ajrit që thithin qytetarët në zonat më të dendura urbane.

#### 12.4 Natyra dhe Biodiversiteti

Pasuria natyrore dhe biodiversiteti i Komunës së Drenasit përbëjnë një aset të rëndësishëm ekologjik, por që ndodhen nën presion të vazhdueshëm nga aktivitetet njerëzore. Duke u bazuar në të dhënat zyrtare dhe kërkesat e nivelit qendror, vlerësimi i këtij sektori është harmonizuar me dokumentet kombëtare të mbrojtjes së natyrës.

##### 12.4.1 Gjendja sipas Raportit Nacional

Në hartimin e këtij kapitulli është marrë për bazë detyrimisht “**Raporti për Gjendjen e Natyrës në Kosovë 2018–2021**”, i hartuar nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK). Sipas këtij raporti, ekosistemet pyjore në shkallë vendi po përballen me degradim si pasojë e fragmentimit të habitateve, ndryshimeve të përdorimit të tokës dhe prerjeve ilegale. Kjo gjendje pasqyrohet drejtpërdrejt edhe në territorin e Drenasit, ku ruajtja e llojeve autoktone të florës dhe faunës kërkon masa urgjente mbrojtëse.

##### 12.4.2 Sipërfaqet pyjore dhe Speciet

Komuna disponon rreth **6,500 hektarë pyje**, që përbëjnë afërsisht **22% të territorit**. Zonat më të rëndësishme janë masivet pyjore në Pallanik, Çyçavicë dhe Kosmaq.

- **Flora:** Dominojnë pyjet e dushkut dhe ahut, me përzierje të llojeve shkurreore. Raporti 2018-2021 thekson rëndësinë e këtyre zonave si korridor ekologjik për qarkullimin e specieve.
- **Fauna:** Territori shërben si habitat për speciet e egra si lepuri i egër, dhelpra, dhe lloje të ndryshme shpendësh, habitatit i të cilëve po ngushtohet nga urbanizimi.

##### 12.4.3 Presionet dhe kërcënimet

Në linjë me gjetjet e raportit nacional, kërcënimet kryesore në Drenas janë:

1. **Fragmentimi i Habitave:** Ndërtimet e pakontrolluara po ndajnë masivet pyjore në pjesë të izoluar, duke penguar riprodhimin e specieve.
2. **Prerjet ilegale dhe Zjarret:** Vetëm gjatë vitit 2023 janë regjistruar mbi 80 raste të prerjeve pa leje dhe disa zjarre fushore që kanë dëmtuar sipërfaqet rigjeneruese.

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

3. **Ndotja industriale:** Emetimet nga industria e rëndë ndikojnë në shëndetin e vegjetacionit rrethues, duke shkaktuar tharje të parakohshme të disa llojeve drunore.

### 12.4.4 Masat e parapara

Në përputhje me legjislacionin dhe udhëzimet kombëtare për mbrojtjen e natyrës Komuna e Drenasit përmes këtij plani (PLVM 2026-2030) synon:

- Identifikimin dhe propozimin e zonave të reja për mbrojtje lokale;
- Ripyllëzimin e 10 hektarëve të degraduar me lloje drunore autoktone;
- Rritjen e kontrollit inspektues për të parandaluar dëmtimin e mëtutjeshëm të natyrës, ashtu siç rekomandohet në raportin 2018-2021.

### 12.5 Mjedisi Social dhe Ekonomik

Sipas Regjistrimit të Popullsisë 2024 (ASK), komuna ka **48,079 banorë**.

Shpërndarja: 74.4% jetojnë në zona rurale ku bujqësia është burimi kryesor i jetesës, ndërsa industria (Ferronikeli) kontribuon me 40% në të ardhurat familjare, duke krijuar varësi ekonomike nga një sektor me ndikim të lartë mjedisor

### 12.6 Turizmi

Edhe pse një zonë industriale, Drenasi ka potencial për turizëm rural dhe kulturor (monumentet e luftës, peizazhet kodrinore). Megjithatë, ndotja e lumenjve dhe deponitë ilegale e bëjnë këtë sektor të pashfrytëzuar. Zgjidhja e problemeve mjedisore është parakusht për zhvillimin e turizmit.

Tabela 3. Tabelë përmbledhëse – Popullsia e Komunës së Glllogovcit sipas vendbanimit (2024), <https://askapi.rks-gov.net/Custom/b45ca5db-09d5-4c97-9258-9d262cd8216f.pdf>

Nr.	Vendbanimi	Gjithsej	Meshkuj	Femra
	<b>KOMUNA E GLLGOVCIT</b>	<b>48,079</b>	<b>24,134</b>	<b>23,945</b>
1	Abri e Epërme	1,027	525	502
2	Arllat	2,348	1,144	1,204
3	Baicë	1,965	1,010	955

PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

4	Çikatovë e Re (U)	1,880	926	954
5	Çikatovë e Vjetër	1,085	549	536
6	Dobroshec	1,125	575	550
7	Domanck	517	265	252
8	Fushticë e Epërme	780	391	389
9	Fushticë e Ulët	738	375	363
10	Gllabar	1,378	721	657
11	Gllanasellë	1,086	528	558
12	Gllogoc (U)	7,081	3,490	3,591
13	Godanc	210	108	102
14	Gradicë	327	177	150
15	Kishnarekë	1,194	603	591
16	Komoran (U)	3,354	1,672	1,682
17	Korroticë e Epërme	1,158	602	556
18	Korroticë e Ulët	990	516	474
19	Krajkovë	958	493	465
20	Likoshan	332	174	158
21	Llapushnik	2,904	1,430	1,474
22	Negroc	960	466	494
23	Nekoc	2,498	1,235	1,263
24	Poklek	1,875	930	945
25	Polluzhë	693	359	334
26	Sankoc	1,178	617	561
27	Shtrubullova	1,193	602	591
28	Shtuticë	614	306	308
29	Tërdec	678	348	330
30	Tërstenik	3,017	1,509	1,508
31	Vasilevë	467	239	228
32	Vërboc	783	389	394
33	Vuçak	238	121	117
34	Zabel i Epërm	421	213	208
35	Zabel i Ulët	1,027	526	501

Zhvillimi i turizmit në Komunën e Drenasit është i lidhur ngushtë me cilësinë e mjedisit dhe ruajtjen e peizazheve natyrore. Edhe pse historikisht njihet si zonë industriale, Drenasi zotëron potenciale të pashfrytëzuara për turizëm kulturor, historik dhe rural, të

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

cilat mund të shërbejnë si burime alternative të ekonomisë lokale për periudhën 2026–2030.

### 12.6.1 Potencialet turistike

- **Turizmi Historik dhe Memorial:** Drenasi është një qendër e rëndësishme e trashëgimisë historike të luftës së fundit në Kosovë. Komplekset memoriale dhe monumentet e shumta të rëndësishme kombëtare tërheqin vizitorë të shumtë, por kërkojnë një rrethim mjedisor të pastër dhe të gjelbëruar për të ofruar një përvojë dinjitoze.
- **Turizmi Rural dhe Peizazhet:** Zonat kodrinore-malore (lartësitë 500-700m) si pyjet e Domanekut, Llapushnikut dhe Çyçavicës ofrojnë mundësi për ecje në natyrë (hiking), çiklizëm malor dhe zhvillimin e bujtinave rurale.

### 12.6.2 Barrierat Mjedisore

Pavarësisht këtyre potencialeve, ky sektor mbetet i bllokuar nga faktorë kritikë mjedisorë të identifikuar në këtë plan:

1. **Ndotja e Lumenjve:** Gjendja e rëndë e lumenjve Sitnica dhe Drenica (me tejkalime të BOD5 dhe amoniakut) i bën brigjet e tyre të papërshtatshme për pika rekreative apo pushimore.
2. **Deponitë ilegale:** Prania e deponive ilegale në afërsi të vendbanimeve dhe zonave historike dëmton estetikën e peizazhit dhe krijon imazh negativ për vizitorët.
3. **Cilësia e ajrit:** Ndotja e lartë industriale (PM10 dhe SO2) gjatë sezonit të dimrit ul interesin për vizita në qendrat urbane të komunës.

### 12.6.3 Vizioni për 2026–2030

Zbatimi i masave të këtij PLVM-je, si eliminimi i 15 deponive kryesore ilegale dhe pastrimi i brigjeve të lumenjve, është parakusht teknik për fillimin e investimeve në infrastrukturën turistike. Synimi i komunës është që përmes restaurimit të natyrës, Drenasi të kthehet në një destinacion ku "Turizmi i Gjelbër" dhe "Turizmi Historik" bashkëjetojnë, duke gjeneruar vende të reja pune për të rinjtë dhe duke rritur mirëqenien sociale të banorëve rurale.

### 12.7 Zhurma (Ndotja Akustike)

Ndotja akustike në Komunën e Drenasit po shndërrohet në një problem shqetësues për shëndetin publik, si pasojë e urbanizimit të shpejtë dhe aktiviteteve intensive ekonomike. Nivelet e zhurmës në pikat kyçe të komunës tejkalojnë rregullisht normat e lejuara për zonat e banimit.

#### 12.7.1 Analiza e niveleve të Zhurmës

Sipas matjeve dhe vlerësimeve në terren, nivelet e zhurmës në zonat urbane të Drenasit dhe Komoranit, veçanërisht pranë rrugëve kryesore, arrijnë deri në **65 - 70 dB**.

- **Krahasimi me Normat:** Ky nivel është dukshëm mbi normën e rekomanduar nga OBSH-ja dhe legjislacioni vendas për zonat e banimit, e cila parashikon një kufi prej **55 dB gjatë ditës** dhe **45 dB gjatë natës**.

#### 12.7.2 Burimet kryesore të ndotjes Akustike

Në territorin e komunës janë identifikuar tri burime kryesore që kontribuojnë në rritjen e zhurmës:

1. **Trafiku rrugor:** Magjistrala Prishtinë-Pejë (M9) dhe qarkullimi i mjeteve të rënda transportuese brenda qytetit janë burimet kryesore të zhurmës konstante. Mungesa e rrugëve anashkaluese (by-pass) bën që zhurma e kamionëve të ndikojë drejtpërdrejt në lagjet e banuara.
2. **Aktivitetet industriale:** Proceset teknologjike në Kombinatin "Ferronikeli" gjenerojnë zhurmë mekanike që dëgjohet në lagjet përreth, sidomos gjatë orëve të natës kur zhurma e ambientit është më e ulët.
3. **Gurthyesit dhe punishtet:** Në zonat periferike dhe rurale, gurthyesit aktivë përbëjnë një burim të lartë të zhurmës dhe dridhjeve, duke dëmtuar qetësinë e banorëve dhe duke ndikuar në habitatin e faunës lokale.

#### 12.7.3 Ndikimi në shëndetin e qytetarëve

Ekspozimi i zgjatur ndaj këtyre niveleve të zhurmës (mbi 65 dB) ka pasojat e drejtpërdrejta te popullata:

- **Stresi dhe Sistemi Nervor:** Rritja e nivelit të kortizolit (hormonit të stresit) dhe irritueshmëria e lartë.
- **Problemet me Gjumin:** Ndërprerja e ciklit të gjumit për banorët që jetojnë pranë rrugëve magjistrale, gjë që çon në lodhje kronike dhe ulje të produktivitetit.
- **Efektet Kardiovaskulare:** Studimet tregojnë një lidhje midis zhurmës konstante të trafikut dhe rritjes së tensionit të gjakut te grupmoshat e vjetra.

### 12.7.4 Masat Strategjike 2026–2030

Për të reduktuar këtë ndotje, PLVM-ja parashikon:

- Vendosjen e **barrierave akustike** (mureve mbrojtëse ndaj zhurmës) në pikat më të ndjeshme përgjatë rrugës M9.
- Krijimin e "brezave të gjelbër" me drunj të dendur rreth zonave industriale që shërbejnë si izolatorë natyrorë të zhurmës.
- Kufizimin e aktiviteteve të gurthyesve dhe makinerive të rënda gjatë fundjavave dhe orëve të natës.

### 12.8 Menaxhimi i Mbeturinave Komunale

Menaxhimi efikas i mbeturinave mbetet një sfidë kritike për Komunën e Drenasit, duke pasur parasysh rritjen e vëllimit të mbeturinave si pasojë e zhvillimit urban dhe aktivitetit industrial. Ky kapitull adreson gjendjen aktuale dhe nevojën emergjente për harmonizim me politikat e reja nacionale.

#### 12.8.1 Gjenerimi dhe Grumbullimi

Në territorin e Komunës së Drenasit prodhohen mesatarisht rreth **7,209 tonë mbeturina në vit**.

- **Mbulueshmëria:** Aktualisht, rreth **82.5%** e ekonomive familjare janë të përfshira në sistemin formal të mbledhjes së mbeturinave përmes kompanisë regjionale "Pastrimi".
- **Sfida:** Pjesa prej rreth **17.5%** e popullsisë, kryesisht në zonat e thella rurale, ende nuk ka qasje të rregullt në shërbim, gjë që shpesh çon në asgjësimin e mbeturinave në rrugë joformale.

#### 12.8.2 Deponitë Ilegale (Pikat e Nxehhta)

Një nga problemet më serioze mjedisore është prania e deponive ilegale. Janë identifikuar mbi **15 pika të nxehhta** (hotspots) aktive, me një sipërfaqe totale të ndotur prej rreth **10,000 m<sup>2</sup>**.

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

- **Lokacionet Kritike:** Zonat më të prekura janë **Gllobar, Tërstenik, Baicë, Komoran dhe Poklek.**
- **Ndikimi:** Këto deponi nuk dëmtojnë vetëm estetikën e peizazhit, por shërbejnë si burim i ndotjes së tokës dhe ujërave nëntokësore përmes lëngjeve kulluese (miat), si dhe rrezikojnë shëndetin publik përmes përhapjes së aromave dhe parazitëve.

### 12.8.3 Tranzicioni drejt Ekonomisë Qarkore

Në përputhje me **Strategjinë (2024–2035) për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Republikën e Kosovës**, Komuna e Drenasit duhet të kalojë nga modeli "prodho-përdor-hidh" drejt **Ekonomisë Qarkore.**

- **Mungesa e Ndarjes në Burim:** Aktualisht, në komunë mungon tërësisht sistemi i ndarjes së mbeturinave në burim (plastikë, letër, metal, qelq). Të gjitha mbeturinat grumbullohen të përziera, gjë që e bën riciklimin pothuajse të pamundur.
- **Mbeturinat Inerte:** Ka një rritje të mbeturinave nga ndërtimtaria, të cilat shpesh përfundojnë në brigjet e lumenjve për shkak të mungesës së një pike specifike grumbullimi për këtë kategori.

### 12.8.4 Objektivat për 2026–2030

Për të përmirësuar gjendjen, ky PLVM parasheh:

1. **Zgjerimin e mbulueshmërisë:** Arritja e 100% të mbulueshmërisë me shërbim formal në të gjitha fshatrat.
2. **Eliminimin e Deponive:** Pastrimin dhe rikultivimin e 15 pikave të nxehta ilegale brenda tri viteve të para.
3. **Pilotimin e Ndarjes në Burim:** Vendosjen e kontejnerëve të veçantë për riciklim në qytetin e Drenasit dhe Komoran si fazë e parë.
4. **Kompostimi shtëpiak:** Shpërndarjen e komposterëve për fermerët në zonat rurale për trajtimin e mbetjeve organike.

### 12.9 Planifikimi Urban, Gjellërimi Publik dhe Zonat Rekreative

Planifikimi i qëndrueshëm urban është shtylla mbi të cilën ndërtohet cilësia e jetës në qytet. Në Komunën e Drenasit, procesi i urbanizimit të shpejtë gjatë dekadës së fundit ka krijuar presione të forta mbi mjedisin, duke rezultuar në zvogëlimin e hapësirave të gjelbra dhe rritjen e densitetit të ndërtimeve pa kriteret e nevojshme mjedisore.

#### 12.9.1 Sfidat e Zhvillimit Urban

Qyteti i Drenasit dhe qendra dytësore e Komoranit kanë pësuar një zgjerim të hovshëm, i cili shpesh ka ndodhur përmes ndërrim-destinimit të tokave bujqësore të klasit të lartë në zona banimi dhe afariste.

- **Efekti i "Ishujve të Nxehtësisë":** Dendësia e lartë e ndërtimeve dhe sipërfaqet e mëdha të asfaltuara në qendër të qytetit kanë rritur temperaturat lokale, duke krijuar një mikroklimë të rënduar gjatë verës.
- **Infrastruktura Përcjellëse:** Rritja e ndërtimeve nuk është shoqëruar gjithmonë me zgjerimin e duhur të rrjetit të kanalizimit atmosferik, gjë që shkakton vështirësi në menaxhimin e ujërave të reshjeve.

#### 12.9.2 Gjellërimi Publik dhe Standardet

Aktualisht, sipërfaqja e gjellërimit për kokë banori në zonat urbane të Drenasit është dukshëm nën standardet evropiane (e cila rekomandon rreth 9 m<sup>2</sup> gjellërim për banor).

- **Mungesa e parqeve:** Qyteti vuan nga mungesa e parqeve qendrore të integruara që shërbejnë si "mëshkëri" të qytetit. Shumica e gjellërimit ekzistues kufizohet në rreshta drunjsh përgjatë rrugëve kryesore, të cilët janë të pamjaftueshëm për të absorbuar sasinë e madhe të grimcave PM10 dhe PM2.5 nga industria.
- **Brezat mbrojtës:** Një problem kyç është mungesa e një brezi të gjelbër mbrojtës (green belt) ndërmjet zonës industriale të Ferronikelit dhe zonave të banimit, i cili do të shërbente si filtër natyror për pluhurin dhe zhurmën.

#### 12.9.3 Zonat rekreative dhe sportive

Kërkesa për zona rekreative dhe terrene sportive është në rritje, sidomos nga popullata e re (mbi 32% e banorëve janë nën moshën 25 vjeç).

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

- **Gjendja:** Zonat ekzistuese sportive janë të kufizuara dhe shpesh të rrethuara nga ndotja e trafikut. Ka një nevojë emergjente për krijimin e korridoreve ekologjike që lidhin qytetin me zonat kodrinore-malore përreth, duke mundësuar aktivitete si ecja dhe çiklizmi.

### 12.9.4 Vizioni për 2026–2030

Për të përmirësuar planifikimin urban, Komuna përmes këtij plani synon:

1. **Integrimin e Infrastrukturës së Gjelbër:** Çdo leje e re ndërtimi për komplekse banesore do të kushtëzohet me përqindje strikte të hapësirës së gjelbër.
2. **Krijimin e "Parqeve të Lagjes":** Identifikimin e parcelave komunale nëpër lagje për t'i shndërruar në zona të vogla rekreative.
3. **Pyllëzimin Urban:** Mbjelljen e specieve drunore autoktone që janë rezistente ndaj ndotjes dhe që kanë kapacitet të lartë të thithjes së gazeve ndotëse.
4. **Shtigjet e Gjelbra:** Lidhjen e qendrës së qytetit me lumin Drenica përmes një shëtitoreje të gjelbëruar, duke restauruar brigjet e lumit si zona pushimi.

### 12.10 Mbrojtja e tokës bujqësore, pyjeve dhe zhvillimi i turizmit

Ky nënkapitull trajton ndërlidhjen vitale midis resurseve primare të komunës (tokës dhe pyjeve) dhe potencialit për zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm. Mbrojtja e këtyre aseteve është parakusht për diversifikimin e ekonomisë lokale të Drenasit.

#### 12.10.1 Mbrojtja e tokës bujqësore

Toka bujqësore në Drenas, me një sipërfaqe aktive prej rreth 12,000 hektarësh, po përballlet me degradim fizik dhe kimik.

**Ndërrim-destinimi:** Një problem kyç është shndërrimi i tokave të bukës (klasit të parë dhe të dytë) në zona ndërtimi, lagje banimi dhe objekte industriale. Ky trend po fragmenton parcelat bujqësore dhe po ul kapacitetin vetë-ushqyes të komunës.

**Ndotja nga Agro-teknika:** Siç u theksua edhe në debatin publik, përdorimi i pakontrolluar i plehrave artificiale pa analiza paraprake të tokës po dëmton strukturën e saj. PLVM 2026–2030 parasheh masa për kufizimin e këtyre plehrave dhe kalimin drejt bujqësisë organike, si një mundësi për certifikimin e produkteve lokale për eksport.

### 12.10.2 Ruajtja e pyjeve dhe biodiversitetit

Pyjet mbulojnë rreth 22% të territorit të komunës (rreth 6,500 ha), kryesisht në zonat e Pallanikut, Çyçavicës dhe Kosmaqit.

Sfidat: Prerjet ilegale (mbi 80 raste të raportuara në vitin 2023) dhe zjarret sezonale mbeten kërcënimet kryesore. Kjo çon në erozion të tokës dhe humbje të habitateve për faunën autoktone.

Objekti: Sipas këtij plani, synohet ripyllëzimi i menjëhershëm i 10 hektarëve të parë në zonat më të degraduara dhe rritja e mbikëqyrjes përmes inspektoratit komunal dhe APK-së.

### 12.10.3 Zhvillimi i turizmit rural dhe kulturor

Vizioni i Drenasit për vitet 2026–2030 përfshin promovimin e turizmit si një alternativë ndaj industrisë së rëndë.

Potencialet: Trashëgimia historike (monumentet e luftës, memorialet) dhe peizazhet natyrore në fshatrat malore ofrojnë mundësi të shkëlqyera për ekoturizëm dhe turizëm të shëndetshëm.

Varësia nga Mjedi: Aktualisht, ky sektor pengohet nga deponitë ilegale dhe ndotja e lumenjve. Zgjidhja e problemeve të mbeturinave dhe pastrimi i brigjeve të lumenjve Sitnica dhe Drenica (të parapara në kapitujt 12.2 dhe 12.8) do të rrisin menjëherë atraktivitetin e komunës për vizitorët.

Integrimi: Plani inkurajon investimet private në bujtina rurale dhe infrastrukturë përcjellëse (shtigje për ecje dhe biçikleta), duke i lidhur pikat historike me ato natyrore. Mbrojtja e tokës dhe pyjeve nuk është vetëm çështje ekologjike, por një strategji e mirëfilltë ekonomike që mundëson një Drenas më të pastër dhe më atraktiv për investime të gjelbra.

### 12.11 Mbrojtja e biodiversitetit (Masat e veçanta)

Ky plan parasheh krijimin e korridoreve ekologjike që lidhin zonat pyjore dhe restaurimin e ekosistemit lumor të lumin Drenica, duke mbjellë drunj autoktone (ah, dushk) për të parandaluar zhdukjen e specieve të florës dhe faunës.

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

### **12.12 Mbrojtja nga zhurma (Masat teknike)**

Identifikohet nevoja për vendosjen e barrierave akustike në rrugët magjistrale dhe kufizimin e aktiviteteve industriale zhurmuese gjatë orëve të natës, si dhe rritjen e brezit të gjelbër mbrojtës rreth fabrikave.

### 13. ANALIZA SWOT (PIKAT E FORTA, TË DOBËTA, MUNDËSITË DHE KËRCËNIMET)

Për të hartuar një strategji mjedisore efektive për periudhën 2026–2030, është përdorur metoda SWOT. Kjo analizë ofron një pasqyrë të qartë të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në gjendjen mjedisore të Komunës së Drenasit, duke evidentuar sfidat kritike që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme.

PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBËTA
<p><b>1. Pozitë strategjike</b>  <b>gjeografike:</b> Vendndodhja qendrore dhe qasja në arteriet kryesore (M9) lehtëson logjistikën për menaxhimin e mbeturinave dhe zhvillimin industrial.</p>	<p><b>1. Nivel kritik i ndotjes së ajrit:</b> Tejkalimi i rregullt i normave të PM10 (45 µg/m<sup>3</sup>), PM2.5 dhe SO<sub>2</sub> për shkak të teknologjisë së vjetër filtruese në industrinë e rëndë dhe përdorimit të thëngjillit për ngrohje.</p>
<p><b>2. Pasuri me burime ujore:</b> Lumenjtë Sitnica dhe Drenica ofrojnë potencial të madh për ujitje në bujqësi dhe krijimin e korridoreve ekologjike, nëse trajtohen siç duhet.</p>	<p><b>2. Mungesë totale e Trajtimit të Ujërave të Zeza:</b> Mosfunksionimi i Impiantit (ITUZ) shkakton derdhjen e ujërave të ndotura direkt në lumenj, duke shkatërruar ekosistemin lumor dhe rrezikuar ujërat nëntokësore.</p>
<p><b>3. Fuqi punëtore e kualifikuar:</b>                      Tradita e gjatë industriale siguron një bazë të mirë teknike për kalimin drejt teknologjive të gjelbra dhe menaxhimit të ndërmarrjeve mjedisore.</p>	<p><b>3. Menaxhim jo-adekuat i mbeturinave:</b> Mungesa e infrastrukturës për ndarjen në burim dhe prezenca e 15-18 deponive ilegale aktive që ndotin tokën dhe peizazhin e komunës.</p>
<p><b>4. Vullneti politik për Agjendën e Gjelbër:</b> Harmonizimi i planeve lokale me ato të BE-së (Agjenda e gjelbër)</p>	<p><b>4. Degradimi dhe fragmentimi i tokës:</b> Ndërtimet e pakontrolluara në toka pjellore dhe ndotja kimike nga</p>

PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

tregon gatishmërinë e komunës për të prioritetizuar mbrojtjen e mjedisit.	përdorimi i tepërt i plehrave artificiale pa analiza paraprake agroteknike.
<b>5. Ekzistenca e sistemeve bazë të monitorimit:</b> Prania e stacioneve të AMMK-së që ofrojnë të dhëna për cilësinë e ajrit, duke mundësuar reagim të bazuar në fakte.	<b>5. Infrastrukturë e vjetruar e ujësjellësit:</b> Humbje të larta të ujit në rrjet (rreth 35-40%) dhe mungesë e mbulueshmërisë së plotë me ujë të pijshëm në zonat rurale.
<b>MUNDËSITË</b>	<b>KËRCËNIMET</b>
<b>1. Thithja e fondeve ndërkombëtare:</b> Programet e BE-së, UNDP-së dhe donatorëve të tjerë ofrojnë grante për efikasitet të energjisë, dekarbonizim dhe trajtim të ujërave.	<b>1. Ndryshimet klimatike dhe vërshimet:</b> Rritja e reshjeve ekstreme rrezikon përmbytjen e zonave pranë lumenjve Sitnica dhe Drenica, duke shkaktuar dëme të mëdha ekonomike.
<b>2. Modernizimi i industrisë:</b> Përdorimi i filtrave të gjeneratës së fundit në industri mund ta shndërrojë Drenasin nga një "hotspot" ndotjeje në një model të zhvillimit të qëndrueshëm.	<b>2. Rritja e kostove të shëndetit publik:</b> Cilësia e dobët e ajrit rrit shpenzimet mjekësore për qytetarët dhe ul produktivitetin e fuqisë punëtore për shkak të sëmundjeve respiratore kronike.
<b>3. Zhvillimi i bujqësisë organike:</b> Pastrimi i tokës nga kimikatet dhe certifikimi i produkteve "Bio" hap mundësi për eksport në tregun evropian me çmime më të larta.	<b>3. Migrimi i popullatës dhe "Brain Drain":</b> Ndotja e lartë mjedisore dhe cilësia e ulët e jetesës mund të nxisë të rinjtë dhe profesionistët të largohen drejt qyteteve më të pastra.
<b>4. Energjia e ripërtëritshme:</b> Pozita gjeografike lejon investime në panele solare dhe përdorimin e nxehtësisë industriale (ko-gjenerimi) për ngrohje qendrore të qytetit.	<b>4. Humbja e pakthyeshme e biodiversitetit:</b> Ndotja e vazhdueshme e ujërave dhe tokës rrezikon zhdukjen e llojeve autoktone të florës dhe faunës, duke dëmtuar zinxhirin ushqimor.

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

<p><b>5. Turizmi rural dhe ekoturizmi:</b> Pastrimi i deponive ilegale dhe restaurimi i natyrës krijon kushte për zhvillimin e turizmit rreth monumenteve historike dhe zonave malore.</p>	<p><b>5. Sanksionet dhe gjobat ligjore:</b> Mospërbushja e standardeve të kërkuara nga BE dhe MMPHI mund të çojë në bllokimin e fondeve apo sanksione financiare për komunën.</p>
--	---

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

### 14. PLANI I VEPRIMIT, PRIORITETET DHE AKTIVITETET 2026–2030

Ky plan veprimi përcakton hapat konkretë që Komuna e Drenasit do të ndërmarrë për të adresuar problemet mjedisore të identifikuara. Aktivitetet janë ranguar sipas urgjencës dhe fizibilitetit të tyre në tri faza kohore.

#### 14.1 PRIORITETET AFATSHKURTRA (2026–2028)

Kjo fazë fokusohet në veprime të menjëhershme, fushata ndërgjegjësimi dhe rregullime infrastrukturore që kanë kosto të ulët por ndikim të lartë social.

Tabela 4. Prioritetet afatshkurtra

Nr.	Aktiviteti i propozuar	Afati	Institucioni Përgjegjës
1	Trajnime për fermerët mbi përdorimin e plehrave dhe materieve të rrezikshme (ndërrimi i plehrave artificiale me ato organike)	2026	DUMM / Drejtoria e Bujqësisë
2	Rregullimi i deponive ilegale, vendosja e tabelave ndaluese dhe gjobat	2026-2027	Komuna e Drenasit / Inspektorati
3	Fushata informuese për amvisëritë për mos-përdorimin e thëngjillit për ngrohje	2026-2027	DUMM / DSHPE
4	Ndërtimi i parkingjeve të reja dhe rregullimi i vendndaljeve të autobusëve	2026-2027	Drejtoria e Infrastrukturës
5	Ndërtimi i shtigjeve për biçikleta dhe promovimi i transportit publik	2026-2028	Drejtoria e Infrastrukturës
6	Krijimi i platformës online për raportimin e ndotjeve nga qytetarët	2027	Komuna e Drenasit / DUMM
7	Mbjellja e drunjëve dhe fidanëve në zonat e degraduara (shkolla dhe OJQ)	2028	Drejtoria e Bujqësisë / OJQ

**PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030**

8	Izolimi termik i objekteve publike (shkolla, qendra mjekësore)	2027-2028	Drejtoria e Arsimit / DSHPE
9	Rehabilitimi i 3 zonave të mbeturinave inerte	2028	DUMM / DSHPE

**14.2 PRIORITETET AFATMESME (2026–2030)**

Kjo fazë përfshin projektet që kërkojnë planifikim buxhetor më të gjerë, bashkëpunim me donatorët dhe mirëmbajtje sistematike.

**Tabela 5. Prioritetet afatmesme**

Nr.	Aktiviteti i propozuar	Afati	Institucioni Përgjegjës
1	Identifikimi i deponive ilegale dhe pastrimi periodik i tyre në tërë territorin	2026-2030	DSHPE / Inspektorati
2	Mirëmbajtja e deponisë së mbeturinave inerte dhe ndërtimore	2026-2030	Komuna / Ndërmarrja "Pastrimi"
3	Monitorimi tremujor online i ndotjes së ajrit dhe ujërave sipërfaqësore	2026-2030	DUMM / AMMK / KRU Prishtina
4	Mirëmbajtja dhe zgjerimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike	2026-2030	DSHPE / KRU Prishtina
5	Vendosja e paneleve diellore në objektet publike	2026-2029	Drejtoria e Shërbimeve Publike
6	Pastrimi i brigjeve të lumit Drenica dhe ndalimi i derdhjeve ilegale	2027-2029	DSHPE / Inspektorati

**PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030**

7	Krijimi i bazës së të dhënave në GIS për zonat e gjelbra dhe pyjet	2027-2030	DUMM
8	Fushata "Ekonomia Qarkore" për ndarjen e mbeturinave në burim	2027-2030	Drejtoria e Arsimit / OJQ
9	Instalimi i 5 filtrave për ujërat e ndotura nga bizneset lokale	2028-2030	Inspektorati / Bizneset

**14.3 PRIORITETET AFATGJATA (DERI NË 10 VITE / 2035)**

Prioritetet afatgjata lidhen me transformimin rrënjësor të infrastrukturës mjedisore të komunës.

**Tabela 6. Prioritetet afatgjata**

Nr.	Aktiviteti Strategjik	Synimi
1	<b>ITUZ (Impianti i Trajtimit të Ujërave të Zeza)</b>	Funksionalizimi i plotë i impiantit për trajtimin e 100% të ujërave të zeza urbane.
2	<b>Sistemi i ngrohjes qendrore</b>	Implementimi i projektit për ngrohje qendrore të qytetit.
3	<b>Zero Deponi Ilegale</b>	Arritja e mbulueshmërisë 100% me shërbim të mbeturinave dhe eliminimi i plotë i deponive ilegale.
4	<b>Neutraliteti Klimatik</b>	Reduktimi i cmetimeve të CO <sub>2</sub> në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian për qytetet e gjelbra.

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

### 15. PLANI I AKTIVITETEVE DHE VEPRIMEVE TË PLVM-së 2026-2030

Zbatimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM) 2026–2030 kërkon një angazhim serioz financiar. Kostot e parapara mbulojnë investimet kapitale, pajisjet teknologjike, shërbimet e monitorimit dhe fushatat edukative. Burimet e financimit janë të diversifikuara për të siguruar qëndrueshmërinë e planit.

#### 15.1 Pasqyra e kostove për projektet prioritare (2026–2030)

*Tabela 7. Plani i aktiviteteve dhe veprimeve për periudhën 2026-2030 dhe përgjegjësit për implementim.*

Nr.	Prioriteti mjedisor	Aktiviteti i propozuar	Kostoja e vlerësuar (€)	Burimet e financimit	Institucioni përgjegjës për implementim	Afati i zbatimit
1	Sektori i Ajrit: Cilësia e ajrit dhe ndotja nga trafiku	Pushatë/Informim i ekonomive familjare për mos-përdorim të djegjes së Thengjillit për ngrohje	15,000 €	Komuna e Drenasit	DUMM, DSHPE, Inspektorati	2026 - 2027
		Rritje e gjelbërimit përgjatë rrugëve kryesore	30,000 €	Komuna e Drenasit	DUMM	2026 - 2027
		Ndërtimi i shtigjeve për biçikleta dhe promovim i transportit publik	40,000 €	Komuna e Drenasit	Drejtoria e Infrastrukturës	2026 - 2029
		Ndërtimi dhe zgjerimi dhe mirëmbajtja e parkingjeve	100,000	Komuna e Drenasit	Drejtoria e Infrastrukturës, DSHPE-ja	2026 - 2030
		Ndërtimi dhe zgjerimi i vendnaljeve për autobus	15,000	Komuna e Drenasit	Drejtoria e Infrastrukturës, DSIPE-ja	2026 - 2030
2	Sektori i Ujërave: Mbrojtja e ujërave dhe lumenjve	Pastrimi i brigjeve të lumit Drenica dhe ndalimi i derdhjeve ilegale	30,000	Komuna e Drenasit	Drejtoria për Shërbime Publike, Inspektorati	2027 - 2030
		Instalimi i 5 filtrave të thjeshtë për ujërat e ndotura nga bizneset lokale	10,000	Komuna e Drenasit	Inspektorati Komunal / Bizneset	2028
		Kontrolli dhe raportim tremujor i ndotjes së ujërave sipërfaqësore	5,000	Komuna e Drenasit	DUMM	2026 - 2030
		Mirëmbajtja e kanalizimeve fekale dhe Atmosferike	90,000	Komuna e Drenasit	DSHPE-ja, KRU"Prishtina"	2026 - 2029
3	Sektori i Mbeturinave: Menaxhimi i mbeturinave	Identifikim i deponive ilegale dhe pastrimi periodik i tyre	45,000	Komuna e Drenasit	Drejtoria për Shërbime Publike, Inspektorati	2026 - 2029
		Fushatë vetëdijesimi "Riciklo për Drenasin e Pastër" me shkolla apo biznese	10,000	Komuna e Drenasit	Drejtoria e Arsimit / OJQ lokale	2026 - 2030

PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

		Mirëmbajtja e Deponisë së mbeturinave Inerte/ndërtimore	60,000	Komuna e Drenasit	Komuna e Drenasit / Ndërmarrja "Pastrimi"	2026 - 2029
		Vendosja e tabelave ndaluese për hedhje mbeturinash në zona rurale	3,000	Komuna e Drenasit	DSIPE	2026 - 2029
4	Toka dhe Pyjet: Menaxhimi i tokës dhe zonave të ndotura / Mbrojtja e biodiversitetit dhe pyjeve	Identifikimi dhe rehabilitimi i 3 zonave të mbeturinave inerte	4,500	Komuna e Drenasit	DSIPE-ja	2026-2029
		Rregullimi i deponive të ilegale dhe vendosja e tabelave ndaluese	3,000	Komuna e Drenasit	DSIPE-ja	2026 - 2029
		Fushatë kundër hedhjes së mbeturinave ndërtimore në fshatra	5,000	Komuna e Drenasit	Drejtoria e Inspektionit / DSIPE-ja	2026 - 2029
		Mbjellja e drunjëve dhe fidanëve në zonat e degraduara	25,000	Komuna e Drenasit	DUMM	2027
		Krijimi i bazës së të dhënave në GIS për drunjët e mbjellur dhe zonat e gjelbra	5,000	Komuna e Drenasit	DUMM	2026 - 2029
		Vendosja e tabelave informuese për florën dhe faunën lokale	15,000	Komuna e Drenasit	DUMM	2028
5	Zhurma dhe Edukimi: Edukimi dhe pjesëmarrja e komunitetit	Fushatë " Bashkë për Drenasin e Gjelbërt" me pastrime publike dhe aktivitete në shkolla	3,000	Komuna e Drenasit	Drejtoria e Arsimit / OJQ	2027-2030
		Trajnime për të rinjtë mbi menaxhimin e mjedisit dhe vullnetarizmin	5,000	Komuna e Drenasit / Donatorët	Drejtoria për Kulturë e Rini	2026 - 2027
		Krijimi i një platforme online për raportim të ndotjeve nga qytetarët dhe vendosja e linkut në webfaqen komunale	10,000	Komuna e Drenasit	Komuna e Drenasit / DUMM	2026
6	Sektori i ndryshimeve klimatike: Eficiencia e energjisë dhe energjia e rinovueshme	Izolimi termik i objekteve publike (shkolla, komuna, qendra mjekësore etj).	150,000	FKEE / Komuna e Drenasit	Drejtoria e Arsimit, DSHPE, Donatorët	2027 - 2030
		Vendosja e paneleve diellore në objektet publike	10,000	Donatorët / Komuna e Drenasit	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Donatorët	2027
		Trajnime për kursim energjie për qytetarë dhe biznese	10,000	Komuna e Drenasit	DSIPE / DKA	2029

### 15.2 Strategjia e financimit

Financimi i PLVM-së do të mbështetet në katër shtylla kryesore:

1. **Buxheti i Komunës:** Alokimi i fondeve nga kategoria e investimeve kapitale dhe subvencioneve për projekte me ndikim mjedisor (psh. eficientë energjie, bujqësi organike).
2. **Grantet Qeveritare:** Aplikimi për fonde në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) dhe Ministrinë e Bujqësisë.
3. **Donatorët Ndërkombëtarë:** Partneriteti me BE-në, UNDP-në dhe organizatat e tjera që mbështesin Agjendën e Gjelbër.
4. **Partneriteti Publik-Privat (PPP):** Inkurajimi i industrisë lokale (veçanërisht Ferronikelit dhe gurthyesve) për të investuar në pajisje që reduktojnë ndotjen në burim.

Ky vlerësim i kostove tregon se me një menaxhim efikas të burimeve, Komuna e Drenasit mund të realizojë objektivat e saj mjedisore brenda pesë viteve të ardhshme.

## 16. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi dhe raportimi i rregullt janë elemente kyçe për të siguruar që Plani Lokal i Veprimit në Mjedis (PLVM) 2026–2030 të zbatohet me efikasitet dhe transparencë. Ky kapitull përcakton mekanizmat kontrollues, indikatorët e performancës dhe procedurat e raportimit vjetor.

### 16.1 Qëllimi i monitorimit

Procesi i monitorimit synon të arrijë këto objektiva:

- Vlerësimin e shkallës së realizimit të projekteve të parapara në planin e veprimit;
- Identifikimin e sfidave, pengesave teknike apo mungesave financiare në kohë reale;

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

- Marrjen e vendimeve të bazuara në të dhëna të matshme mjedisore;
- Informimin e vazhdueshëm të qytetarëve dhe institucioneve qendrore mbi gjendjen e mjedisit.

### 16.2 Mekanizmat e monitorimit

Komuna e Drenasit do të përdorë një sistem të strukturuar kontrolli:

1. **Raportimet Tremujore:** Çdo drejtori komunale përgjegjëse (DUMM, DSHPE, Bujqësia) do të dorëzojë raporte të shkurta mbi progresin e aktiviteteve të tyre te Komisioni për PLVM.
2. **Mbledhja e të dhënave teknike:** Verifikimi i progresit do të bëhet përmes sensorëve të ajrit (AMMK), analizave laboratorike të ujit të Sitnicës dhe Drenicës, si dhe regjistrave të operatorëve të mbeturinave.
3. **GIS Mjedisor:** Përdorimi i sistemit GIS për të monitoruar sipërfaqet e ripyllëzuara dhe eliminimin e deponive ilegale.

### 16.3 Indikatorët e performancës (KPI)

Suksesi i planit do të matet përmes këtyre indikatorëve kryesorë:

- **Ajri:** % e uljes së përqendrimit të PM10, PM2.5 dhe SO<sub>2</sub> në zonat urbane.
- **Uji:** % e rritjes së ujërave të zeza që trajtohen para shkarkimit në lumenj.
- **Mbeturinat:** Numri i deponive ilegale të eliminuara dhe % e rritjes së riciklimit.
- **Toka:** Numri i fermerëve të trajnuar për mospërdorimin e plehrave artificiale dhe kalimin në plehërim organik.
- **Biodiversiteti:** Sipërfaqja (në hektarë) e zonave të ripyllëzuara dhe e hapësirave të reja të gjelbra në qytet.

### 16.4 Procesi i raportimit

- **Raporti vjetor i progresit:** Komisioni për PLVM, në bashkëpunim me ekspertin mjedisor, do të përgatisë një raport vjetor të detajuar. Ky raport do të përmbajë analizën e shpenzimeve financiare dhe rezultatet e arritura mjedisore.
- **Transparenca:** Raporti vjetor do të miratohet në Kuvendin Komunal dhe do të publikohet në uebfaqen zyrtare të komunës për t'u qasshëm nga publiku dhe OJQ-të.
- **Raportimi te Ministria:** Sipas nenit 24 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, Komuna e Drenasit do t'i dërgojë Ministrisë (MMPHI) raportin vjetor për të dëshmuar harmonizimin me strategjitë nacionale.

### 16.5 Roli i Komisionit dhe Ekspertit

Komisioni mbikëqyr zbatimin e të gjithë planit dhe koordinon punën ndërmjet drejtorive. Eksperti mjedisor ka për detyrë interpretimin shkencor të të dhënave të monitorimit dhe propozimin e veprimeve korigjuese nëse objektivat nuk arrihen sipas afateve të parapara në kapitullin 14.

## 17. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis (PLVM) 2026–2030 për Komunën e Drenasit është një dokument gjithëpërfshirës që ofron një rrugëtim të qartë drejt përmirësimit të gjendjes mjedisore. Duke u bazuar në analizën DPSIR dhe konsultimet me publikun, plani adreson problemet më akute përmes veprimeve konkrete dhe të matshme.

### 17.1 Përfundimet kryesore

1. **Gjendja mjedisore:** Komuna e Drenasit përballlet me sfida të rëndësishme që burojnë nga aktiviteti industrial (ndotja e ajrit dhe tokës) dhe urbanizimi i shpejtë (mungesa e trajtimit të ujërave të zeza dhe deponitë ilegale).
2. **Saktësia e të dhënave:** Përdorimi i të dhënave të fundit nga Regjistrimi i Popullsisë 2024 (48,079 banorë) ka mundësuar një planifikim më realist të shërbimeve dhe investimeve mjedisore.

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

3. **Prioritetet e synuara:** Cilësia e ajrit (PM10, SO<sub>2</sub>) dhe menaxhim i ujërave mbeten prioritetet kryesore, të ndjekura nga tranzicioni drejt Ekonomisë Qarkore në menaxhimin e mbeturinave.
4. **Përfshirja Qytetare:** Debati publik i datës 14.11.2025 dëshmoi se qytetarët janë të shqetësuar jo vetëm për industrinë, por edhe për cilësinë e tokës dhe rreziqet nga plehurat artificiale në bujqësi, kërkesa këto që janë integruar plotësisht në këtë plan.
5. **Qëndrueshmëria:** Plani i veprimit është i harmonizuar me Strategjinë Kombëtare të Mbeturinave 2024–2035 dhe raportet e fundit të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, duke siguruar koherencë me politikat e nivelit qendror.

### 17.2 Rekomandime për Implementim

Për të garantuar suksesin e këtij dokumenti strategjik, rekomandohen hapat e mëposhtëm:

1. **Forcimi i Kapaciteteve Institucionale:** Drejtoritë komunale duhet të trajnojnë stafin e tyre për monitorimin e Lejeve të Integruara Mjedisore dhe përdorimin e sistemeve GIS për menaxhimin e hapësirave të gjelbra.
2. **Modernizimi i Monitorimit:** Instalimi i stacioneve automatike online për cilësinë e ajrit dhe ujit duhet të realizohet brenda dy viteve të para, për të pasur të dhëna të besueshme për publikun.
3. **Tranzicioni në bujqësi:** Rekomandohet zbatimi i menjëhershëm i trajnimeve për fermerët mbi "Bujqësinë e Mirë", me fokus në zëvendësimin e plehrave kimike artificiale me ato organike, për të mbrojtur pjellorinë e tokës dhe ujërat nëntokësore.
4. **Diversifikimi i financimit:** Komuna duhet të jetë proaktive në aplikimin për grante mjedisore nga Bashkimi Evropian dhe donatorët ndërkombëtarë, duke mos u mjaftuar vetëm me buxhetin komunal.
5. **Zbatimi i Ligjit dhe Gjobat:** Inspektorati komunal duhet të rrisë prezencën në terren për të parandaluar krijimin e deponive të reja ilegale dhe për të kontrolluar emetimet e gurthyesve dhe punishteve lokale.
6. **Rishikimi periodik:** Duke qenë se mjedisi është dinamik, ky plan duhet t'i nënshtrohet një vlerësimi të efektivitetit çdo dy vite, për të bërë përshtatjet e nevojshme teknike.

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030

Zbatimi i këtyre rekomandimeve do ta shndërrojë Komunën e Drenasit në një model të qëndrueshmërisë, duke siguruar një mjedis ku industria e rëndë dhe natyra bashkëjetojnë në ekuilibër për të mirën e shëndetit të të gjithë qytetarëve.

### SIHTOJCA 1: ADRESIMI I KOMENTEVE NGA MINISTRIA

Nr.	Gjetja / Komenti i Ministrisë	Veprimi i ndërmarrë	Përshkrimi i përmirësimit	Kapitulli, nën kapitulli
1	Struktura e dokumentit nuk është e qartë dhe mungon ndarja logjike e kapitujve	E adresuar	Dokumenti është ristrukturuar në kapituj të qartë (metodologjia, aktorët, analiza, plani i veprimit) dhe është shtuar indeksi i tabelave dhe figurave	I gjithë dokumenti
2	Mungon përshkrimi i qartë i metodologjisë së përdorur	E adresuar	Është shtuar kapitulli mbi metodologjinë duke përfshirë modelin DPSIR dhe burimet e të dhënave	Kap. 9
3	Nuk janë përfshirë mjaftueshëm konsultimet publike	E adresuar	Janë përshkruar punëtoritë, debati publik dhe integrimi i komenteve të palëve të interesit	Kap. 9.4 dhe 10

**PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030**

4	Mungon definimi i qartë i aktorëve dhe përgjegjëseve	E adresuar	Është shtuar kapitull i veçantë me listën e aktorëve dhe rolet e institucioneve	Kap. 11
5	Plani i veprimit nuk është mjaftueshëm konkret	E adresuar	Janë specifikuar aktivitetet, institucionet përgjegjëse dhe afatet kohore (afatshkurtër, mesëm dhe gjatë)	Kap. 14
6	Mungojnë indikatorët për monitorim dhe vlerësim	E adresuar	Janë përfshirë indikatorët e performancës (KPI), metodat e verifikimit dhe frekuenca e raportimit	Kap. 16.3
7	Nuk është e qartë lidhja me dokumentet strategjike kombëtare	E adresuar	Është shtuar analiza e detajuar e përputhshmërisë me dokumentet strategjike kombëtare, duke përfshirë lidhjen direkte ndërmjet objektivave dhe masave të PLVM me prioritetet e PKVM dhe strategjive sektoriale, e paraqitur përmes tabelës së harmonizimit	Kap. 6.1
8	Mungon analiza e kostove dhe burimeve të financimit	E adresuar	Është shtuar kapitulli për kostot dhe burimet e financimit për projektet prioritare	Kap. 15
9	Mungon përfshirja e analizës së problemeve mjedisore	E adresuar	Problemet janë identifikuar dhe analizuar përmes modelit DPSIR dhe të dhënave zyrtare	Kap. 12
10	Gabime teknike dhe gjuhësore në dokument	E adresuar	Janë korrigjuar gabimet drejtshkrimore, formatimi dhe përsëritjet në tekst	I gjithë dokumenti

**SHTOJCA 2: Dëshmi nga debati publik**

Në faqet 44 dhe 46 janë integruar kërkësat teknike të qytetarëve nga dëgjimi publik i datës 14.11.2025, lidhur me detajimin e rrezeve nga plehrat artificiale dhe materiet e rrezikshme në bujqësi.

Në këtë shtojcë gjithashtu kemi edhe dëshmitë e debatit publik.

Ky plan hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb-faqin zyrtar të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

Zyrës së Kryetarit ;

- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2026 – 2030



<b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b>			
<b>KOMUNA GLOGOC</b>			
<b>GLOGOC MUNICIPALITY</b>			
PRANUAR		05/12/2025	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
	08-952/01-51786		

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Drenasit  
Drejtorati për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit



## **Shqyrtimi Publik**

### **Plani Lokal i Veprimit në Mjedis i Komunës së Glogocit**

### **2025-2029**

**Datë:** 21.11.2025

Me këtë Raport definohen prioritetet e Komunës dhe masat e nevojshme që duhet ndërmarrë në vazhdimësi për përmisimin e situatës në lidhje me mbrojtjen e mjedisit.

Përgaditja e raportit u bazua në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës së Drenasit (Glogocit), 01Nr.110-6904 dhe Nenit 19 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë.

Ky dokument ka qenë në konsultim publik nga data 30.10.2025 deri me datën 20.11.2025, ndërsa konsultimi publik me qytetarë është mbajtur me datë 14.11.2025 në Sallën e Kuvendit të Komunës duke filluar nga ora 11:00.

Mbledhja u shpall e hapur nga z. Bekim Dobra, i cili prezantoi rendin e ditës dhe punën e ekipit punues. Ai theksoi se njoftimi publik për dokumentet është bërë me kohë dhe se të gjithë palët e interesuara kanë pasur mundësi të paraqesin komentet dhe sugjerimet e tyre. U rikujtua se sugjerimet shitesë mund të dorëzohen deri më datë 20.11.2025, përfshirë edhe përmes emailit zyrtar të komunës.

Më tutje me fjalë rasti:

Drejtori i Drejtorisë, z. Petrit Gashi, falënderoj ekipin komunal dhe kompaninë kontraktuese për angazhimin dhe punën e bërë në draftimin e këtyre dy dokumenteve me rëndësi të madhe për komunën e Drenasit, në aspektin e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimi të qëndrueshëm.

Z.Ibush Luzha ka prezantuar Planin Lokal të Veprimit në Mjedis,gjatë prezentimit pati diskutime,pyetje dhe komente nga pjesëmarrësit:

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2025-2029 objektivë kryesore ka të:

- Identifikojë problemet kryesore mjedisore në territorin e komunës;
- Përcaktohen perioritetet për zgjidhjen e këtyre problemeve;
- Hartojë veprime konkrete dhe projekt-propozime për implementimin afatshkurtër,afatmesëm dhe afatgjatë;
- Promovojë zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe përmirësim të cilësisë së jetës së qytetarëve.

Komente nga pjesëmarrësit:

Z.Faik Hoti kërkoj që në plan të elaborohet në mënyrë më të detajuar materiet e rrezikshme dhe plehu artificial.

Të gjitha kërkesat e tij, janë marr parasyshe si me vend.

LISTA ME PJESMARRËSIT:

Lista e Pjesëmarrësve për Konsultim Publik për planet - PLVM dhe PLSCA I mbajtur me datë 14.11.2025		
Emri	Mbiemri	Nënshkrimi
SHKENDIJE	THAQI	
S KASBAH	DOBRA	
ARBENIË	PATA	
Mir Mexheta	Mexheta	
PETRIË	GASHI	
REHMAN	BAJRAMI	
Aurela	Shiti	
Djellën	Syllaj	
Arbllinda	Morken	
Antigona	Bucalli	
REHMAN HASI		
REHRI	BALECI	
VULECA	BALECI	
Manigom	Gllanera	
Arbenida	Arbenida	
GRANIË	ELSHANI	
Hesime	Gashi	
Edone	Subicaj	
Arton	Hasari	
AFRIM	PROKSHI	
AVDYL	MZIU	
RAMIZ	HALLIJA	



FOTO NGA NGA MBAJTJA E DEBATIT PUBLIK ME QYTETARË



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	05/12		20 25
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
08	052/01	-	51786



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Komuna e Drenasit**  
Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit



Datë/a:	21.11.2025
Për:	Zyrën e Informimit
CC:	Në dosje dhe arkivit
Nga:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Tema:	Procesverbal nga Shqyrtimi Publik i Draft-Planin Lokal të Veprimit në Mjedis dhe Planin Lokal për Strategjinë e Cilësisë së Ajrit

**PROCESVERBALI**

Takimi publik për Draft-Planin Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM) dhe Planin Lokal për Strategjinë e Cilësisë së Ajrit (PLSCA) 2025–2029 u mbajt më datë 14.11.2025 në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 11:00 deri në 12:00.

Mbledhja u shpall e hapur nga z. Bekim Dobra, i cili prezantoi rendin e ditës dhe punën e ekipit punues. Ai theksoi se njoftimi publik për dokumentet është bërë me kohë dhe se të gjithë palët e interesuara kanë pasur mundësi të paraqesin komentet dhe sugjerimet e tyre.

U rikujtua se sugjerimet shtesë mund të dorëzohen deri më datë 20.11.2025, përfshirë edhe përmes emailit zyrtar të komunës.

Më tutje me fjalë rasti:

Drejtori i Drejtorisë, z. Petrit Gashi, falënderoj ekipin komunal dhe kompaninë kontraktuese për angazhimin dhe punën e bërë në draftimin e këtyre dy dokumenteve me rëndësi të madhe për komunën e Drenasit, në aspektin e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimi të qëndrueshëm.

Më pas, përfaqësuesi i kompanisë kontraktuese, z. Ibush Luzha, prezantoi të dy planet. Gjatë prezentimit pati diskutime, pyetje dhe komente nga pjesëmarrësit.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2025-2029 objektivë kryesore ka të:

- Identifikojë problemet kryesore mjedisore në territorin e komunës;
- Përcaktohen prioritetet për zgjidhjen e këtyre problemeve;
- Hartojë veprime konkrete dhe projekt-propozime për implementim afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë;
- Promovojë zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe përmirësim të cilësisë së jetës së qytetarëve.

Plani Lokal për Strategji të Cilësisë së Ajrit 2025-2029 përcaktohen objektivat kryesorë të:

- Ulja e ndotjes industrial;
- Zhvillimi i transportit të qëndrueshëm;
- Përmirësimi i sistemit të ngrohjes;
- Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave;
- Krijimi i sistemit të monitorimit dhe transparencës.

Komente nga pjesëmarrësit:

- Z. Faik Hoti kërkoi që në plan të elaborohen në mënyrë më të detajuar materiet e rrezikshme dhe plehu artificial.

Platformat ku është publikuar njoftimi për konsultim publik:

Webfaqja zyrtare e Komunës së Drenasit:

<https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/10/Njoftimi-per-konsultim-publik-per-Draft-Planin-Lokal-te-Strategjise-se-Cilesise-se-Ajrit-dhe-Plani-Lokal-i-Veprimit-ne-Mjedis-2025-2029.pdf>

[Final.pdf](#)

Plani Lokal për Strategji të Cilësisë së Ajrit 2025-2029: Webfaqja zyrtare e Komunës së Drenasit

<https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/10/PLSCA-Golden-Drafti-Final.pdf>

Rrjeti social Facebook i Komunës së Drenasit: <https://www.facebook.com/komunadrenas>

Dokumentet e bashkëngjitura:

Njoftimi për organizimin e dëgjimit publik

Lista e pjesëmarrësve

Raporti është përgatitur nga:

Shkendije Thaqi

Zyrtar për Mbrojtje të Mjedisit.

